

Fenomene misterioze dhe legjenda te pashpjegueshme, Pergatitur me kujdes te vecante nga ARDIT MUÇA, 08/2010.

Perbindeshi i Loch Ness (liqenit Ness) , Trekendeshi i Bermudes ose me shume Kafka e kristalte Mayane: Te shumta jane misteret qe ushqejne imagjinate e njerezimit per shkak se keto mistere kurre nuk jane zgjidhur. Shume shpjegime racionale kane perparuar por asnje nuk eshte provuar teresisht bindese, duke lene pa pergjigje, ne nje pikepyetje zonat e erreta te ketyre fenomeneve misterioze. Ja disa nga keto fenomene misterioze dhe te pashpjegueshme :

- Perbindeshi i liqenit Ness



Legjenda e perbindeshit te Loch Ness ze fill (nis) nga Mesjeta por ka njohur nje entuziazem te vertet gjate ketyre dy shekujve te fundit.

Ka me shume se nje mije deshmi lidhur me paraqitjen e ketij perbindeshi ne kete liqen, me qindra foto ashtu si dhe me dhjetera video (me pak fjale prova te shumta).

Sipas informacioneve qe jane ne dispozision deri me sot, kafsha eshte fizikisht e afrueshme me zvarraniket detare te epokes se Jurasik .

Shume kerkime jane nderrmarre por kushtet e veshtira per shfrytezimin e liqenit skocez, eksplorimin e tij , kane bere qe ti japin fund kerkimeve dhe nje perfundim.

- Trekendeshi i Bermudes



Trekendeshi i Bermudes, eshte nje zone e Oqeanit Atlantik ne mes te ishullit Bermuda, bregdetit lindor te Florides dhe Porto Riko.

Ky trekendesh, eshte ne origjinen e nje numeri jastezakonisht te larte i zdukjeve te anijeve dhe te avioneve.

Shperthim i papritur i motorave, humbjen e lidhjeve te radiove, coroditje te busulles dhe shume fenomene te tjera te cuditshme, kane ndihmuar ne krijimin e kesaj legjende. Disa kane hedhur supozimin e nje difekt te hapsires se perkoheshme, por shkencetaret, ne vend te kesaj hipoteze te krijuar, kane perparuar ne kerkimet e tyre hipotezen e turbullimit magnetik dhe shperthimit te metanit.

Te gjitha keto propozime e hipoteza do te ngelen ne zonen e teorise per arsye sepse ato jane te paprovueshme.

- Yeti



Yeti eshte nje krijese legjendare e Nepalit, gjusem-njeri, gjusem-majmun, te cilet mbushen lartesite e Himalajes. Shume eksplorues dhe alpinista, pretendojne se i kane pare gjete rruges se tyre. Deshmite biles kalojne dhe kufinjte, qe kane pare gjithashtu te njejtat krijesa ne Shtetet e Bashkuara te Amerikes (Bigfoot), ne Kanada

(Sasquatch) apo ne Kaukaz (Almasty).

Megjithate, deshmite e ekzsitences se kesaj krijese jane shume te pakta: ndonje gjurme kembesh dhe disa foto te paqarta.

Supozimet shkojne nga pasardhesit e Njeriut te Neanderthals tek gorrilla prehistorike, e ruajtur duke kaluar nga primitive te thjeshte te pershtatur me mjediset malore.

- Ceshtja Roswell



Ne 1947, nje disk fluturues(ufo) perplaset ne token e nje ferme prane Roswell,New Mexico. Sherifi paralajmeron ushtrine, e cila menjehere merr pjeset e mbetura te ketij disku fluturues, duke i mbajtur larg nga popullsia dhe te fshehura.

Sipas deshmimtareve, si njerez te thjeshte dhe ushtare, per keta do te ishte nje disk fluturues me pasagjer te cilet nuk kane mbijetuar. Shume deshmi te panumerta, informacione dhe dokumenta oficiale kontradiktore, te mbledhura gjate viteve me pas, kane mbyllur plotesisht rruget e kesaj ceshtjeje.

Nje raport i koses se fundit nga Forcat Ajrore ka shprehur se OVNI (ufo) ka qene ne te vertet nje eksperiment sekret te trasportit ne formen e nje topi (te madh) me nje radio trasmentuese per te gjetur raketa berthamore. Por shume ekspert bien ne kundersiztim me kete shpjegim nga ana e ushtrise .

- Kafka e Kristalte Mayan



Gjate shekullit te XIX-t, kafka te kristalta te qyteterimit te Maya, qarkullojne ne mesin e antikitareve dhe koleksionisteve. Por, maya, ate kohe me shume pak pajisje, nuk kishin absolutisht asnje menyre per te gdhendur kaq me imtesi, kristal kuarzi, nje nga guret me te veshtire dhe me te forte.

Pas ekspertizes, shumica e ketyre kafkave dolen ne perfundim se ishin fallco. Vetem dy prej tyre jane vertetuar qe vine nga epoka e Maya. Saktesia e madhesise se tyre dhe persosja anatomikembeten nje enigme per te gjithë ekspertet, ndersa shume te tjetre mendojne se keto kafka kane origjine ekstraterreste .

- Misteri i Atlantis



Ne Trime dhe Critias te Platonit, qe eshte permendur per here te pare ekzistenca e Atlantis, nje ishull strehimi, nje qyteterim i lashte shume i zhvilluar, e gelltitur nga valet. Cuditerisht, ky mit shfaqet dhe ne qyteterimet

Amerindiane.

Shume kohe e konsideruar si nje legjende e cuditshme, disa studiues dhe historian megjithate kane gjetur karakteristika arkeologjike, qe perkojne (bashkangjiten) me tekstet e Platonit. Problemi eshte se te gjithe mbeshtesin secili teorine e tij, ne pike te ndryshme gjeografike: Krete, Deti i Verit, Acores ose Oqeani Indian, gje qe e ben origjinen e Atlantis te pazgjidhshme.

- Shirat e kafsheve



Nga antikiteti deri ne ditet e sotme, deshmi te shumta, pershkruajne shira te cuditshme te bera nga peshq, bretkoca, zogj, gjarperinj minj apo dhe karkaleca. Disa ia atribuojne keto shira nje zemerimi hyjnor. I vetmi shpjegim shkencor i avancuar deri tani, eshte aspirata e kafsheve drejt qiellit nga tornadot dhe uraganet qe ti lirojne pak kilomentra me larg. Por ky argument nuk shpjegon , se pse nje lloj specie e vetme kafshe eshte e terhequr te bjere pa lene gjurme.

- Mitologjia kosmogonike e Dogon-eve



Ne 1946, dy antropologe francez, zbuluan se feja e Dogon-

eve (nje popull i vogel ne Mali), eshte e bazuar ne parimet kosmogonike shume te mprehta, te cilat kerkojne njohuri astrofizike te paarritshme, pa teknologji moderne, dhe per kete arsye shume larg dogon-eve . Ata pretedojne se kjo njohuri u vjen nga subjekte jashtokesore, Nommo, te cilet i u jane prezantuar atyre si krijuesit tane.

Historianet besojme me shume , se njohurite e dogon-eve duhet te jene trasmentuar nga qyteterimi ne qyteterim, duke nisur nga Greqia antike dhe Mesopotamia, qe te dyja te zhvilluara ne astronomi, por nuk mund te shpjegojne te gjithë kosmogonin dogon-e

- Kafsha e Gevaudan



Ne 1764, sulme shume te dhunshme ne rajonin Gevaudan, duke synuar kryesisht femijet dhe vajzat e reja, kane perhapur nje panik te madh tek banuesit e kesaj zone, deri ne ate pike sa ceshtja shkon deri ne mbreterimin e Mbretit Luigji XV-te.

Pershkrimet e grumbulluara nga deshmitë dhe gjendja e viktimave, ndonjehere deri ne koka te prera, bejne te mendojne se kane te bejne me nje kafshe te egert te natyres ose nje demon.

Shume familjar te goditur nga fatkeqesia e humbjes se dikujt te rrethit familjar, jane organizuar ne perpjekje per te kapur kete bishe te eger . Por gjithmone keto perpjekje kane qene te kota. Keto vrasje te tmerrshme marrin fund tre vjet me vone ku ruajti i pyllit, Jean Chastel, me ne fund arrin ta vراسi. Disa mendojne se Jean, ne te vertete e kishte mesuar kafshen (nje qen-ujk) te vriste dhe te bente krime perverse. gje qe shpjegon se pse kjo kafshe sulmonte gjithmone dhe vetem njerzit . Por kjo ceshtje ngelet nje enigme e madhe sot e kesaj dite .

- Te humburit e Mary Celeste



Ne 5 dhjetor 1872, ekuipazhi i Dei Grata, gjen, ne meshire te fatit, nje anije fantazme, Mary Celeste, totalisht e braktisur, qe te pakten prej dy javesh, bazuar nga ditari i bordit te anijes. Efektet personale te marinareve, ushqimet dhe mallrat qe kishin ne bord kishin ngelur te paprekura. Nuk ka patur asnje shenje dhune vetem disa demtime te voglamund te sinjalojne, e cila largon hipotezes e nje kryengritje apo sulmi nga piratet. Spekullimet drejtohen tek sulmi i nje oktapodi gjigand dhe te nje ishulli misterioz qe kane gelltitur te gjithë eukipazhin. Asnje shpjegim racional nuk duket i pershtatshem per te zbuluar kete enigme .

Ka shume mistrere dhe legjenda te cuditshme qe na rrethojne ketu e shume shekuj me pare qe ne bejne te mendojme per shume e shume teori ... Ndoshta valle nuk jemi te vetmit banore te kesaj hapësire qiellore ose ndoshta natyra nuk do te na tregoje te gjitha sekretet e saj ose jane vete njerzit te cilet i kane krijuar per nje qellim te caktuar Gjithsesi ka shume mistere te cilat jane per tu zbuluar dhe ndoshta kurre nuk do te zbulohen por do ngelen gjithmone mistere dhe legjenda

Shkruar: Ardit Muça

Nga përvoja mistike e njerëzve tanë


NGJARJE QË TË LËNË PA MEND

Në shtëpinë tonë filluan të ndodhin disa fenomene misterioze. Fenomene të pashpjegueshme e të çuditshme. Madje, aq të çuditshme, sa për njeriun që nuk ka pasur rast t'i përjetoj këto, vërtet mund të jenë edhe të pabesueshme. Ashtu, siç kanë mundur të jenë të pabesueshme edhe për ne, para se të na binin në kokë...

Në lagjen "Tusus" të Prizrenit ndodhet shtëpia e Akip Shahinit nga Prizreni, ku qe shumë vite me radhë, xha Akipi jeton me plakën e tij dhe me katër djem, të gjithë të martuar, që së bashku me reja dhe nipa e mbesa, përbëjnë gjithsej 24 anëtarë të familjes.

Një familje e qetë, me djem të mbarë e punëtorë, dhe një shtëpi "e gjallë", siç do të thuhej në popullin tonë - janë karakteristikat e para që të bien në sy kur, për të parën herë, ndodhesh në këtë familje. Katër shtëpi në një oborr i kanë ndërtuar ata të xha Akipit, pa meshkuj në botën e jashtme, por vetëm me punën e mbarë që këtu e bëjnë. Respektivisht, djemtë e xha Akipt kanë dy gjellëtore: një në Prizren dhe një tjetër në Pejë, ku fitojnë mirë. Kurse xha Akipi ka edhe tokë pune...

Dhe të gjitha premiset materiale janë të favorshme, që do të duhet të mundësonin një jetë të qetë familjare dhe një kënaqësi në gjithë atë begati e në gjithë ato të mira materiale, por - një hall që i ka rënë mbi kokë kësaj familjeje, nuk u lë qetësi e as kënaqësi shpirtërore anëtarëve të saj.



Problemet lindën pas një viti martesë

Qe tri vjet me radhë reja e djalit të vogël, Nafija, me prejardhje nga K. Është e sëmurë rëndë nga një sëmundje shpirtërore. Kurrë më parë nuk ka qenë e sëmurë. Edhe një kohë pas martesës me Aliun nuk pati kurrfarë probleme. E çonin mirë dhe kishin harmoni me njëri-tjetrin. Problemet e tyre lindën pa u mbushur një vit i plotë në martesë. Nafija filloi ta humbte vetëdijen. Respektivisht ajo binte në një gjendje të ndryshuar të vetëdijes dhe ajo gjendje zgjaste jo pak kohë... shpeshherë edhe nga disa orë.

Në fillim, natyrisht, iu drejtuam mjekut - fillon rrëfimin halle madh Aliu. Neuropsikiatri, pas dëgjimit indiferent të përshkrimit të sëmundjes nga ana jonë, Nafijes i preferon t'i bënte gjithë analizat dhe incizimin e kokës në EEG. Dhe, çuditërisht, të gjitha analizat e trurit e të trupit i dolën mirë, pos konstatimit nga ana e mjekut se "është pak nervoze"... Dhe i dha disa barëra për qetësim.

Sakaq, mbretëria e sëmundjes në Nafijen mbeti e paprekur. Sulmet vazhdonin. Nafija binte edhe më tej në gjendje të ndryshuar të vetëdijes dhe ndjehej tejet keq. Forca të panjohura negative e sulmonin, e mundonin, e lodhnin...Madje edhe e rrihnin... E rrihnin shpinës dhe këmbëve!...

Në shtëpi ndodhin fenomene misterioze

Njëkohësisht me këtë, në shtëpinë tonë filluan të ndodhin disa fenomene misterioze. Fenomene të pashpjegueshme e të çuditshme, - shton Aliu. Madje, aq të çuditshme, sa për njeriun që nuk ka pasur rast t'i përjetoj këto, vërtet mund të jenë edhe të pabesueshme. Ashtu, siç kanë mundur të jenë të pabesueshme edhe për ne, para se të na binin në kokë...

Së pari filluam të ndjenim një prani të qenieve të padukshme. Në fillim na dukej sikur dikush po ecte nëpër ballkone, ose dëgjonim rënie, sikur dikush kërcente nga ballkoni poshtë. Pastaj dëgjonim hedhje gurësh, goditje me gurë. Goditjet sidomos i ndodhnin Nafijes.

Të them të drejtën, në fillim edhe ne ishim shumë të befasuar e në një dilemë të madhe: T'u besonim atyre fenomeneve të çuditshme, të pakapshme për mendjen e logjikën, apo të mos u besonim... T'u besonim, si t'u besonim, kur asgjë me sytë e ballit nuk shihnim, asgjë s'vërenim konkretisht. Të mos besonim, si të mos besonim, kur për një kohë të caktuar, dëgjonim zhurmat, trokitjet, rrapëllimat, hedhjet e gurëve, ecjen e dikujt... Me një fjalë, pandërprerë shihnim, dëgjonim dhe përjetonim manifestimet e çuditshme, mahnitëse, që shkaktoheshin nga qenie të padukshme, misterioze, si të thuash, ireale, por që manifestimi i veprimeve të tyre ishte real dhe ne e dëgjonim, e shihnim dhe e përjetonim në mënyrë reale e të pakontestueshme...

Në fillim na ka ndodhur që, kur kemi shkuar në dhomë, t'i gjejmë rrobat e nxjerra nga raftet, ku ishin të paluara, e të vendosura në mes të dhomës, në dysheme. Valixhet i gjenim të hapura, pa i prekur kush nga anëtarët e familjes, por, ajo çka ishte më e keqja, më pastaj rrobat e nuses do t'i gjenim të prera e të dëmtuara. Të prera si me gërshërë,. Si t'i kishte prerë me dorë njeriu. Ndoshta gjatë kësaj kohe na janë asgjësuar rroba me vlerë prej disa mijëra markash në këtë mënyrë të pashpjegueshme. Pastaj, e gjenim arin e prishur. Ose e gjenim të përdredhur e të lakuar ose të prerë... Dhe atë si me zhiletë, sa në shikim të parë, nuk mund të vërehej se ishte i prerë, vetëm kur e kapje me dorë, ndahej...

Por, ndërkohë, ne, që kishim hall të madh, kurse mjeku nuk mund të na ndihmonte, filluam të kërkojmë ndihmë tek disa milexhionë, falltarë e hoxhallarë të ndryshëm - kyçet në bisedë xha Akipi. Një nga ata, nga fshati Lubinjë e Epërme bëri që Nafije të tregonte se kush po e sulmonte, kush po e mundonte e kush po e rrihte. Ua zinte në gojë emrat. Fliste me to, grindej. Tregonte se ç'i thoshin... Fatkeqësisht, ajo që i paraqitej, që e sulmonte kështu e që i bënte këto të zeza ishte gruaja e vëllait tim..., ofshau ai.

Në foto shihet regalli i djegur, pothuajse plotësisht i dëmtuar, në dhomën e Ali Shahinit, i shkaktuar nga duart e padukshme dhe e pashpjegueshme përmes mendjes dhe logjikës

Katër herë u kallën dhomat

Është interesant, se gjithnjë e paralajmëronin se çdo të ndodh. I thoshin se kemi për t'i prerë rrobat, të cilat edhe i preheshin. Pastaj, i thoshin se kemi për t'i djegur dhe ato digjeshin. Katër herë na janë djegur dhomat. Dhe atë gjithnjë ditën. Dy herë jemi djegur paradite. Një herë në kohë dreke dhe një herë vonë pas dite. Është interesant se herën e parë, kur ka ndodhur ndezja, dera ishte e mbyllur përbrenda, e askush nuk ishte brenda. Madje, kur e kemi thyer derën, dhe e shtynim për ta hapur, një forcë e çuditshme e shtynte nga parapapa. Disi nuk na linte të hynim brenda. Tri herë, i kemi shpëtuar gjërat pak më mirë, herën e katërt na është djegur, madje edhe regalli. Dhe ashtu, të djegur, e kemi edhe sot e kësaj dite...

Por më tepër kishim frikë se do të na i digjte fëmijët, - thotë xha Akipi. Prandaj, rregullisht Aliu i ka ndërruar dhomat, me shpresë se ndoshta në dhomën tjetër nuk do t'i ndodhte gjë, edhe pse kot...

Njëherë, madje, i janë prerë rrobat që i kishte të veshura. Bluzën, veç kur ia pamë të prerë prapa, në shpinë, dhe mbetëm të nemitur... - kyçet prapë Aliu. Dy herë diçka e panjohur më ka grithur edhe mua në ballë. Isha duke punuar në gjellëtore, dhe, kur një qastë, paqëllimshëm shikohem në pasqyrë, shoh, shoh një vijë, një të grithur pjerrtas ballit, pa ndonjë rast dhe pa ndonjë mundësi që të grithesha askund... Edhe kjo (tregon për të shoqen), ka qenë dy herë e prerë në dorë, pa ndonjë rast. Veç kur ia shihnim gjakun...

Prania e vazhdueshme e qenieve të padukshme

Kurse, vazhdimisht kemi pasur zhurma të ndryshme: të trokitura në dyer, dritare, regall... Disa herë janë thyer dritaret dhe atë çuditërisht, nga ana e brendshme, d.m.th. krahu i brendshëm i dritares... Disa herë ma kanë marr orën e zgjimit, të cilën e lë afër për t'u zgjuar, kur kam për të shkuar në punë... Pastaj, sërish ma kthenin!...

Por të gjitha këto që i thamë (e që nuk) janë sigurisht pak, megjithatë, nuk paraqesin gjithë atë që kemi përjetuar brenda kësaj kohe, brenda këtyre tri viteve, prej kur Perëndia na e çoi këtë hall mbi kokë... - kyçet, përsëri, në bisedë xha Akipi. 74 vjet i kam bërë - vazhdon, kurrë nuk kam parë këso gjërash. Dëgjuar nga të tjerët, se dikujt i ka ndodhur po, veç në familje të ngushtë dhe në farefis nuk na ka ndodhur. Tash Zoti na ka dërguar, pse na i ka dërguar, Ai e di...- përfundon xha Akipi dhe shpreson, megjithatë, se do të bëhet mirë. Dhe ne e ngushëllojmë, se, si çdo gjë që është kalimtare në këtë jetë edhe kjo do të jetë kalimtare dhe do të bëhet mirë...

Tani tërë familja shpresat i kanë përqendruar tek A. Kolgeci, një person që pa kursim përpiqet t'u ndihmoj njerëzve të shërohen me metoda alternative, kryesisht përmes sugjestionit dhe hipnozës. Kolgeci e ka mësuar Nafijen, pas disa seancave hipnotike, që kur ta sulmojnë ato krijesa të liga, ajo, gjithnjë duke e konsultuar "udhëheqësin e vet shpirtërorë", të dijë si të mbrohet, madje edhe t'i sulmoj ato me energji pozitive...

Sipas sugjerimeve të Kolgecit, dy -tri ditë para se ta bënim këtë bisedë, ajo i kishte "sulmuar" ato dhe atë kryesoren e kishte "asgjësuar". Sipas rrëfimit të Nafijes, ajo e kishte asgjësuar



Në foto shihet pasqyra e thyer nga forcat e panjohura. Familja Shahini nuk kanë shpjegim se si ka ndodhur kjo, ata vetëm e kanë parë se është thyer nga një dorë e padukshme, në praninë e tyre dhe kanë mbetur të nemitur...



Njollat e gjakut që shpërthyen në mur në çastin kur Nafija e ka "sulmuar" me energji (në gjendje autohipnotike) dhe "asgjësuar" njëherë nga qeniet misterioze.

plotësisht “trupin” e saj! E kishte parë saktë këtë. Por, që çudia të jetë më e madhe, at qastë që ka ndodhur ky “asgjësim” në njërin mur të dhomës, çuditërisht, ishin paraqitur njolla të vërteta gjaku...! Gjurmët e tij akoma ndodheshin në murin e dhomës, të cilat miku im S. Krasniqi, i fotografoi, për t’i pasur si dëshmi të një sensacioni të vërtet misterioz.

P.s.

Ngjarja e përshkruar është e vërtet dhe të gjitha të dhënat janë autentike: vetëm emrat e personazheve janë të ndryshuar.

Fenomene te mistershme paranormale

Shkenca ka fuqinë të shfrytëzojë energjinë, t’i lejojë njerëzit të fluturojnë, të ndihmojë në kurimin e sëmundjeve dhe të shpjegojë shumë rreth botës.

Por, edhe pse është e mrekullueshme dhe e dobishme, shkenca nuk mund të shpjegojë gjithçka. Shkencëtarët mund të mos e zbulojnë kurrë se si ka lindur universi e as nuk mund të ndihmojnë në zgjidhjen e çështjeve të besimit, ashtu si kanë lënë të pashpjeguara plotësisht edhe fenomenet që lidhen me botën paranormale.

Edhe pse mund të shpjegojë shumë fenomene të çuditshme, disa mistere mbeten për t’u zgjidhur - shpeshherë sepse nuk ka informacion të mjaftueshëm për të arritur në një vendim përfundimtar.

Disa nga këto fenomene ndoshta një ditë do të kuptohen plotësisht, si shumë gjëra që dikur ishin mistere dhe të pashpjegueshme (si për shembull, shkaqet e sëmundjeve) tashmë janë një njohuri e përgjithshme...

Megjithatë për epokën tonë ato mbeten ende mistere dhe askush deri më sot nuk ka arritur t’i shpjegojë, të paktën në mënyrë të kënaqshme.

Lidhja trup/mendje

Shkenca mjekësore vetëm sa ka filluar të kuptojë mënyrat se si mendja ndikon trupin. Efekti Placebo për shembull, tregon se njerëzit mund të çlirohen nga simptoma të ndryshme sëmundjesh vetëm duke besuar se kurat janë efektive, pavarësisht nëse ato janë apo jo.

Studimet kanë treguar se gjatë periudhave të traumave, njerëzit ngulitin përvoja që kanë nivele të larta përmbajtjeje emocionale.

Trupi mund të mbajë informacion përtej nivelit të ndërgjegjes, si mekanizëm mbrojtës, kështu që kujtimet priren të shkëputen ose të kthehen në amnezi.

Informacioni nuk është i vlefshëm në gjendjen normale të ndërgjegjshme dhe mekanizmi mbrojtës i trupit na mban larg nga pozicioni ku vetëdija e trup/mendjes sonë e interpreton të dhimbshme apo traumatike.

Një zonjë e quajtur Evy McDonald në vitin 1980 u diagnostikua me sëmundjen Amyotrophic Lateral Sclerosis. Mjekët i dhanë asaj vetëm një vit jetë.

Sot, pas shumë vitesh, ajo jo vetëm që është gjallë, por gëzon shëndet të plotë. Duke përdorur vetëm procese të kuptuara në mënyrë të thjeshtë, aftësitë e trupit për të shëruar veten janë shumë më mbresëlënëse se çdo lloj gjëje që mjekësia moderne mund të krijojë.

Fuqia psikike dhe perceptimi superndijor

Fuqitë psikike dhe perceptimet superndijore renditen në majë të fenomeneve të pashpjeguara, jo për ndonjë arsye tjetër veç bindjes shumë të përhapur në të.

Psikika i referohet forcave apo agjentëve me natyrë paranormale. Kërkuesit kanë testuar njerëz që pretendojnë se kanë fuqi psikike, ndonëse rezultatet nën kushtet e kontrolluara në mënyrë

specifike kanë qenë negative ose të paqarta.

Disa kanë argumentuar se fuqitë psikike nuk mund të testohen ose, për disa arsye, zvogëlohen në prani të skeptikëve apo shkencëtarëve.

Nëse kjo është e vërtetë, shkenca nuk do të jetë kurrë e aftë të provojë apo të përgënjeshtrojë ekzistencën e fuqisë psikike. Nga i fitojnë fuqitë psikikët? Skeptikët argumentojnë se hilet dhe fuqia e sugjestionimit është gjithçka që ka lidhje me fuqitë psikike.

Ata që besojnë, zakonisht mendojnë se është një dhunti që e kanë të gjithë njerëzit, por shumica nuk e zhvillojnë. Disa njerëz kanë lindur me këtë dhunti të zhvilluar fuqishëm. Dhuntia është argumentuar si ndjeshmëri e zmadhuar e të gjitha apo disa shqisave.

Përvojat në prag të vdekjes dhe jeta pas saj

Njerëzit që kanë qenë njëherë pranë vdekjes kanë raportuar përvoja mistike, si: shkëputja prej trupit, ngritja në ajër, prania e një qenie shumë të dashur prej drite - ndonjëherë e interpretuar si Perëndia, duke kaluar në një tunel e pas kësaj duke dalë në dritë, duke u bashkuar me të dashurit e tyre etj.

Meqenëse këto përvoja janë të thella, askush nuk është kthyer me prova apo informacione të vërtetueshme nga "përtej varrit".

Komuniteti shkencor është shumë i përçarë në këto përvoja. Skeptikët sugjerojnë se ato janë të shpjegueshme si natyrale dhe halucinacione të parashikueshme nga truri i traumatizuar.

Ndërsa shkencëtarët paranormalë i etiketojnë si dëshmi e jetës së përtejme. Raste të tilla shpeshherë janë raportuar pasi individë është shpallur i vdekur klinikisht, ose shumë pranë vdekjes.

Me zhvillimet e reja në teknikat e kardiologjisë, numri i këtyre përvojave po rritet në mënyrë të vazhdueshme. Nëse janë apo jo

halucinante këto përvoja, kanë efekt tek vëzhguesi.

Shumë raporte të përvojës pranë vdekjes duken se përfshijnë elemente të cilët, sipas disa teoricienëve, mund të shpjegohen vetëm nga vetëdija jashtë trupit. Për shembull, një grua e përshkroi në mënyrë të detajuar një instrument kirurgjik të cilin nuk e kish parë më parë, po ashtu edhe një bisedë që kishte ndodhur ndërsa ajo ishte në anestezi totale.

Në një tjetër rrëfim, në Holandë, një infermiere i hoqi protezat e dhëmbëve një pacienti të pavetëdijshëm, që vuante nga një atak në zemër dhe kur po dilte nga spitali ia kërkoi t'ia kthente.

Nëse janë ose jo paranormale këto përvoja, asnjë nuk mund ta vërtetojë plotësisht apo ta hedhë poshtë. Megjithatë është e qartë që asnjë model psikologjik apo fiziologjik nuk mund t'i shpjegojë të gjitha përmbajtjet e përvojave pranë vdekjes.

Dukuria paradoksale e ngritjes në ajër, vetëdija e kthjellët dhe mendimet logjike gjatë periudhës së paaftësisë së aktivitetit cerebral ngre shumë pikëpyetje për kuptimin tonë rreth vetëdijes dhe lidhjen me funksionimin e trurit. Debati vazhdon ende, pa gjetur një zgjidhje logjike.

UFO-t

Nuk ka dyshim se disqet fluturues të njohura si UFO - Objekte Fluturuese të Paignifikuara [Unidentified Flying

Objects] ekzistojnë - shumë njerëz shohin gjëra në qiell që nuk mund t'i identifikojnë, duke i renditur nga avionët te meteorët. Nëse këto objekte dhe drita janë ose jo anije jashtëtokësore, kjo është një çështje tjetër.

Duke i dhënë distancat fantastike dhe përpjekjet e përfshira në ardhjen në Tokë nga universi, një skenar i tillë duket i

pabesueshëm. Edhe pse hetime të kujdesshme kanë zbuluar shkaqe të njohura për raportet më të para, disa incidente UFO-sh do të mbeten gjithnjë të pashpjeguara.

Raportime për fenomene të pazakontë ajrorë datojnë që në kohët e lashta (disqe fluturuese në piktura shpellash në Hunian 47.000 vjet para Krishtit.

Në jug të Francës 20.000 vjet para Krishtit etj.), por raportimet e shikimit të UFO-ve nisën të bëheshin më të zakonshëm pasi u reklamuan gjerësisht në Shtetet e Bashkuara në vitin 1947.

Që prej asaj kohe janë raportuar me dhjetëra mijëra raste. Një shkencë e re me emrin Ufologji merret me përpjekjet kolektive të atyre që studiojnë raportet mbi UFO-t dhe provat e shoqëruara.

Edhe pse Ufologjia nuk përfaqëson një program akademik kërkimi, UFO-t kanë qenë subjekt i shumë hetimeve gjatë viteve.

Gjatë zbritjes së një disku fluturues në korrik të viti 1952 , i parë me imazhe nga radarë mbi Uashington, FBI-ja u informua nga inteligjenca e drejtorisë së forcave ajrore. Ata mendonin se "disqet fluturuese" nuk ishin as iluzione optike e as fenomene atmosferike, por ata shtuan se disa oficerë ushtarakë po konsiderojnë seriozisht mundësinë e anijeve ndërplanetare. CIA nisi shqyrtimin e brendshëm shkencor ditën tjetër.

Disa shkencëtarë të CIA-s po i konsideronin seriozisht si jashtëtokësorë. Përkrah vëzhgimeve të imazheve, rastet ndonjëherë kanë edhe prova fizike (kontakte me radarë ose fotografi , gjurmë të uljes së anijes, interferenca elektromagnetike dhe efekte fiziologjike dhe biologjike) duke përfshirë shumë raste të studiuara nga ushtria.

Statistikat e përpiluara nga studimet e forcave ajrore të Shteteve të Bashkuara nga 1947 deri në 1970, kanë zbuluar se epërsia e fortë e vëzhgimeve të identifikuar vinte si pasojë e keqidentifikimeve, mashtrimeve dhe nga këto, tregimet

jonormale përbënin një përqindje të vogël të të gjithë rasteve.

Shumë vëzhgime të UFO-ve janë ngjarje kalimtare dhe zakonisht nuk ka asnjë mundësi për përsëritjen e testit nga metoda shkencore. Pavarësisht këtyre, shumë raste mbeten të pashpjeguara.

Fantazmat

Që nga tragjedia e Doruntinës, kur i vëllai Kostandini, u ngrit nga varri për të mbajtur amanetin, deri te filmat me fantazma, shpirtrat e të vdekurve janë shfaqur shpesh në kulturën dhe folklorin tonë.

Shumë njerëz kanë raportuar se kanë parë shfaqje të hijeve të panjohura si edhe të njerëzve të dashur apo të të afërmve.

Edhe pse prova përfundimtare për fantazmat mbeten të pakuptueshme, dëshmues të sigurtë vazhdojnë të raportojnë pamje, duke fotografuar deri madje duke komunikuar me fantazmat.

Fenomeni mund të përfshijë shfaqje, shqetësime me zhurma të mistershme, frymëmarrje të ftohta, tinguj hapash, zëra si edhe aroma të ndryshme.

Fantazmat janë fenomen tepër i diskutuar. Kritikët e dëshmitarëve okularë të fantazmave sugjerojnë se kufizimi i perceptimit njerëzor dhe shpjegimi i zakonshëm fizik mund të arsyetojnë shikime të tilla.

Për shembull, ndryshimi i trysnisë në një shtëpi mund të bëj dyert që të përplasen ose dritat nga një makinë kalimtare mund të reflektojnë përmes dritares natën.

Sipas hetuesit skeptik Joe Nickell: "...shikimi periferik është shumë i ndjeshëm dhe mund të mashtrohet lehtë, sidomos natën vonë, kur truri është i lodhur dhe ka më shumë mundësi t'i

keqinterpretuon pamjet dhe tingujt. Mendohet që tingulli është një tjetër shkak për shikimin e fantazmave.

Frekuencat më të ulëta se 20 hertz quhen infra tinguj dhe janë normalisht të padëgjueshme, por shkencëtarët britanikë Richard Lord dhe Richard Wiseman kanë nxjerrë përfundimin se "infra tingujt mund t'i bëjnë njerëzit të ndjejnë prani të huaja në dhomë apo ndjenja të pashpjegueshme ankthi apo frike.

Helmimi me monoksid karboni, që mund të shkaktojë dëgjim të fuqishëm dhe halucinacione pamore, depresion dhe ndjesi të përgjithshme sëmundjeje dhe frike, është njohur si shpjegim i mundshëm për shtëpitë e pushtuara nga fantazmat, që nga vitit 1921".

Disa kërkues, si profesor Michael Persinger, kanë arsyetuar se ndryshimet në fushat gjeomagnetike (të krijuara nga lëkundjet tektonike në koren e tokës apo në aktivitetin diellor) mund të stimulojnë tëmthat e trurit dhe të prodhojnë shumë nga përvojat e shoqëruara me fantazmat.

E gjithë kjo hipotezë është kundërshtuar dhe ka hapur një debat të gjerë. Ndërsa hetuesit e fantazmave shpresojnë që një ditë të provojnë se të vdekurit mund të kontaktojnë me të gjallët, duke siguruar një përgjigje përfundimtare ndaj misterit.

Deja Vu

Deja vu është një shprehje franceze që do të thotë "e parë më parë", duke iu referuar një ndjesie të veçantë, të çuditshme, të qartë dhe të mistershme njëkohësisht, sikur një skenë apo rrethanë e caktuar duket e përjetuar më parë.

Deja vu-ja është përkufizuar si "të kujtosh të ardhmen". Përvoja e "mëparshme" shpeshherë i atribuohet një ëndrre, megjithëse në disa raste është një ndjenjë e fortë se kjo situatë ka ndodhur me të vërtetë në të kaluarën.

Disa ia atribuojnë deja vu-në përvojave psikike ose sekuenca të pakërkuara të jetëve të mëparshme.

Përvoja e deja vu-së duket se është shumë e përhapur. Në studime formale rreth 70% e njerëzve kanë raportuar se kanë përjetuar të paktën një herë (kjo përqindje i përket grup moshës nga 15-25, kur mendja është ende subjektive për të vënë re ndryshimet në mjedisin rrethues).

Referenca të përvojave të deja vu-së gjithashtu janë gjetur në literatura të kaluara, duke dëshmuar se nuk është fenomen i ri.

Një person mund të dijë rrugën apo peizazhin e një qyteti që nuk e ka vizituar më parë, duke u habitur në të njëjtën kohë se si ka mundësi të ndodhë.

Disa sugjerojnë se leximi i një rrëfimi të detajuar të një vendi mund të përfundojë në këtë ndjesi, kur më vonë ky vend vizitohet. Shpjegimi më i zakonshëm nuk e sheh deja vu-në si akt i njohjeve paraprake apo profecisë, por një anomali e kujtesës.

Një tjetër teori e shpjeguar është ajo e vegimeve. Ashtu si sugjeron teoria, një sy mund ta regjistrojë atë që sheh një fraksion sekonde më shpejt se tjetri, duke krijuar atë ndjesi të fortë kujtese mbi të njëjtën skenë e parë në të njëjtën e sekondës më vonë nga syri tjetër.

Megjithatë edhe kjo dështon në shpjegimin e fenomenit kur janë të përfshirë edhe informacione të tjerë ndijorë, si pjesa dëgjimore dhe veçanërisht pjesa dixhitale.

Një lidhje reciproke klinike është gjetur mes përvojës së deja vu-së dhe çrregullimeve, si skizofrenia apo ankthi, dhe se përvoja ka gjasa të rritet me subjektet që janë në këto kushte.

Ky korrelacion i ka çuar disa kërkues për të spekuluar se përvoja e deja vu-së është anomali neurologjike e lidhur me shkarkimet e tepërta elektrike në tru.

Bashkë me intuitën, kërkimet në psikologjinë njerëzore mund të ofrojnë më shumë shpjegime natyraliste, por përfundimisht shkaku dhe natyra e vetë fenomenit mbeten mister.

Zhdukjet misterioze

Njerëzit zhduken për arsye të ndryshme. Disa arratisen, disa humbasin në aksidente, disa rrëmbehen dhe vriten, por pjesa më e madhe janë gjetur. Kjo nuk ka ndodhur me zhdukjet vërtet të misterioze. Që nga ekuipazhi i Marie Celeste të Jimmy Hoffa, Amelia Earhart, dhe Natalee Holloway, disa njerëz janë zhdukur pa lënë gjurmë.

Kur personat e humbur janë gjetur, ka ndodhur gjithmonë përmes punës kërkimore të policisë, dëshmitëve ose aksidenteve, kurrë prej detektivëve psikikë.

Por kur provat mungojnë dhe udhëheqësit kanë humbur, as policia dhe as shkenca tradicionale nuk mund të zgjidhin krimin.

1872, Mary Celeste: anija u nis për lundrim nga porti i Nju Jorkut drejt Xhenovës në Itali më 5 nëntor. Anija britanike "De Gratia" e zbuloi anijen të braktisur në 5 dhjetor.

Të gjithë në bordin e Mary Celeste-s ishin zhdukur: kapiteni, familja e tij dhe 14 burrat e ekuipazhit. Anija ishte krejtësisht në rregull me furnizim të bollshëm dhe nuk kishte asnjë shenjë dhune. Fati i ekuipazhit mbetet mister edhe sot e kësaj dite.

1918, Ciklopi, Bashkim Sovjetik: flota detare me qymyr duhej të shpërndante karburant dhe lëndë të tjera në luftanijen në Shtetet e Bashkuara gjatë Luftës së Parë Botërore. Ajo u zhduk gjatë rrugës nga Brazili për në Baltimorë.

Anija ankoroi për pak kohë në ishujt Barbados më 3-4 mars. Meqenëse nuk arriti në datën e paracaktuar, 13 mars, në

Baltimorë, filluan kërkimet, por as rrënojat e saj dhe asnjë nga 309 personat në bord nuk u gjetën kurrë. Shkaku i humbjes mbetet ende i panjohur.

1928, Köbenhavn: anija trajnuese e lundrimit me ekuipazh prej 75 vetash, duke përfshirë edhe 45 kadetë, lundronte nga River Plate drejt Melburnit, Australi më 14 dhjetor.

Kontakti i fundit me radio me anijen u bë më 22 dhjetor dhe gjithçka dukej mirë. Köbenhavn-i dhe ekuipazhi i saj u zhdukën pa asnjë gjurmë dhe askush nuk e di se çfarë u ka ndodhur.

Sipas një shkrimtari paranormal John Keel, shumë zhdukje paranormale mund të jenë rezultat i vrimës në fabrikën e realitetit, ku njerëzit apo objektet kalojnë përmes një vrime jashtë së njohurës, duke lëvizur në një dimension tjetër, duke mbetur jashtë botës sonë në terma të kohës dhe hapësirës, duke iu shkaktuar zhdukjen.

Një numër i konsiderueshëm zhdukjesh implikojnë UFO-t, si rasti i Frederick Valentich, një pilot 20-vjeçar, i cili u zhduk në një fluturim nga King Island në ngushticën australiane mes Viktorias dhe Tasmanisë më 21 tetor 1978.

Trekëndëshi i Bermudave i njohur gjithashtu si trekëndëshi i djallit është një zonë në veriperëndim të Oqeanit Atlantik, në të cilin një numër avionësh dhe anijesh lundruese janë zhdukur në ato të ashtuquajtura rrethana përtej kufijve të gabimit njerëzor apo veprimtarive të natyrës.

Disa prej tyre i atribuohen paranormales: një pezullim i ligjeve të Fizikës ose aktivitet i qenieve jashtëtokësore. Edhe pse incidente të shumta janë raportuar pa saktësi ose janë zbuluar nga autorët e vonshëm, shumë të tjera mbeten të pashpjeguara.

Intuita

Megjithëse e quajmë ndjesi të brendshme, "shqisë të gjashtë"

etj., të gjithë e kemi përjetuar intuitën në një situatë apo në një tjetër. Sigurisht, ndjenjat e brendshme shpeshherë janë të gabuara, por ato duken se janë të vërteta në shumicën e rasteve.

Shumë njerëz besojnë se intuita është një formë fuqie psikike, një mënyrë për të futur misterin apo njohuritë e veçanta rreth botës së të ardhmes.

Psikologët vërejnë se njerëzit në mënyrë të pavetëdijshme marrin informacion rreth botës që na rrethon, duke na udhëhequr në një skenë të dukshme ose informacion të njohur, pa e kuptuar saktë se si apo përse e dimë. Por rastet e intuitës janë të vështira për t'u provuar apo studiuar dhe psikologjia mund të jetë vetëm një pjesë e përgjigjes.

Nga përkufizimi, intuita nuk ka vlefshmëri objektive. Gjithsesi është shumë e përhapur si një fenomen i dukshëm. Për këtë arsye është bërë subjekt i studimeve në Psikologji, si edhe çështje e interesit për të mbinatyrshmen.

Intuita supozohet të jetë një formë e hyrjes së drejtpërdrejtë. Por, hyrje e drejtpërdrejtë në çfarë?

Ndoshta intuita është mënyra e mendjes për të ndërvepruar drejtpërdrejt me idealet platonike apo esencat fenomenologjike. Kanti ka thënë se si hapësira, ashtu dhe koha janë të lidhura me intuitën.

Me fjalë të tjera, ai mendonte se shqisat ndërveprojnë me intuitat tona transshendente për të prodhuar një njohuri sintetike a priori. Seria e të dhënave të përftuara nga shqisat tona apo përvojat shqisore përbëjnë intuitën. Dikush mund të argumentojë se intuita është e pavarur nga shqisat tona. Kështu që këto mund të mos jenë pasojë e informacioneve shqisore të llogaritjes apo të procedimit dhe manipulimit të së njëjtës.

Bergson-i e përshkruan si një lloj intuitede empatike instiktive, e

cila percepton objekte dhe njerëz, identifikohet me ta dhe në këtë mënyrë derivon njohuri rreth absolutes.

Spinoza mendonte se njohuria intuitive është më superiore (si njohuri empirike dhe njohuri shkencore). Ajo bashkon mendjen me qenien e përjetshme dhe zbulon atë në një univers të lashtë e të shenjtë.

Por a janë intuitat me të vërtetë a priori apo zhvillohen si përgjigje të një realiteti relativisht të qëndrueshëm në ndërveprim me të? A kemi pasur intuita në një univers kaotik, kapriçioz, të paparashikueshëm dhe të parregullt?

Dhjetë historitë më misterioze në botë

Nga Stonehenge, Kenedi, arka e Noes e deri tek mbreti Artur

Histori të panumërta misterioze që përshkojnë anë e mbanë botën. Fenomene të veçantë dhe ngjarje të habitshme. Këto mistere kanë shumë vite që ekzistojnë dhe ende mbeten të pazgjidhura. E fillojmë nga misteri i Stonehenge-it. Stonehenge është ndërtuar në tre seksione mbi 6.400 vjet nga banorët neolit të Salisbury Plain në jug të Anglisë, Stonehenge ka mahnitur vizitorët për mijëra vjet. Kjo sipërfaqe përmban 30 gurë të drejtë me peshë 26 tonë dhe 30 gurë horizontal të lartë. Çdo gur peshon 6 ton dhe është gdhendur nga "bluestone" nga një vend disa kilometra larg. Ndërtuesit neolit ishin në gjendje për të krijuar një monument që ka hutuar njerëzimit për mijëra vjet duke përdorur mjete vetëm të përbëra nga guri. Edhe pas gjithë këtyre viteve, askush nuk e di arsyen e vërtetë të ndërtimit të Stonehenge-it. Misteri tjetër që ka kjo vepër gjigante është dhe konstrukti i saj dhe ajo ç'ka bie më në sy janë gurët blu të përdorur, të cilët janë me përmasa gjigante. Misteri tjetër është edhe misteri që e gjithë bota gjithnjë i kushton vëmendje. E kemi fjalën për vrasjen e John F.Kennedy. Ky i fundit u qëllua një herë në shpinë dhe një herë në kokë teksa udhëtonte me gruan e tij Jacqueline në karvanin presidencial nëpër rrugët e Dallas, Texas më 22 nëntor, 1963.

Lee Harvey Osëald u arrestua 45 minuta më pas të shtënave kundrejt Kenned-it. Pas disa orësh të marrjes në pyetje pa ndjekur shumë procedura ai u akuzua për vrasje. Më pas u vra nga Jack Ruby në garazhin e ndërtesës së policisë më 24 nëntor para qindra gazetarëve. Më 29 nëntor, Presidenti Lyndon B. Johnson krijoi një komision të quajtur "Warren" për të hetuar rreth vrasjes. Komisionin e drejtonte Earl Warren, Shefi i Drejtësisë i Shteteve të Bashkuara, dhe gjeti se Osëald ishte vrasësi i vetëm dhe se ai e bëri vrasjen nga kati i gjashtë i një ndërtese që shërbente si depozituese librash shkollor. Arma të cilën kishte përdorur ishte një pushkë italiane Mannlicher-Carcano. Një tjetër mister i madh është varri i Vlad Draculës. Konti Drakula, "Drakula i vërtetë" ishte në fakt një princ i Ëallachia (tani pjesë e Rumanisë). Një mbrojtës i mirë kundër turqve, ai është portretizuar si një hero, patriot dhe një horr i pamëshirshëm. Vlad Drakula ishte një sundimtar i egër i cili ka torturuar në mes 40.000 dhe 100.000 të armiqve të tij, të dy turqit dhe bashkatdhetarët e tjerë që përbënin një kërcënim për pushtetin e tij. Ai u vra në betejën kundër turqve pranë Bukureshtit në 1476. Turqit pas e vranë ja prenë kokën dhe ja dërguan sulltanit të Perandorisë Osmane, Mehmetit II. Pjesa tjetër e trupit të tij ende nuk dihet se ku. Një tjetër mister i takon mbretit Artur. A ekziston me të vërtetë një nga mbretërit më të famshëm apo është vetëm një legjendë në mënyrë që të frymëzohen trupat anglez? Për herë të parë është përmendur nga një klerik i Ëellsit i quajtur Nennius në shekullin e nëntë. Megjithatë, kontributi më i plotë i është njohur historisë së mbretërve të Britanisë, e cila daton në shekullin e dymbëdhjetë. Aty pohohej se mbreti Artur ishte i patejkalueshëm në pushtet dhe në diplomaci, një mbret i madh luftëtar i cili drejtoi Uellsin, Skocin, Irlandën, Norvegjin, Danimarkën, Gjermanin, Anglinë dhe Galin. Përflitet që historia e tij të jetë e rreme por kjo nuk shmang dashurinë që njerëzit kanë për legjendën e mbretit Artur.

10. Misteri i Stonehenge-it

Stonehenge është ndërtuar në tre seksione mbi 6.400 vjet nga banorët neolit të Salisbury Plain në jug të Anglisë, Stonehenge ka mahnitur vizitorët për mijëra vjet. Kjo sipërfaqe përmban 30 gurë të drejtë me peshë 26 tonë dhe 30 gurë horizontal të

lartë. Çdo gur peshon 6 ton dhe është gdhendur nga "bluestone" nga një vend disa kilometra larg. Ndërtuesit neolit ishin në gjendje për të krijuar një monument që ka hutuar njerëzimit për mijëra vjet duke përdorur mjete vetëm të përbëra nga guri. Edhe pas gjithë këtyre viteve, askush nuk e di arsyen e vërtetë të ndërtimit të Stonehenge-it. Misteri tjetër që ka kjo vepër gjigante është dhe konstrukti i saj dhe ajo ç'ka bie më në sy janë gurët blu të përdorur, të cilët janë me përmasa gjigante.

9. Vrasja e John F.Kennedy

John F.Kennedy u qëllua një herë në shpinë dhe një herë në kokë teksa udhëtonte me gruan e tij Jacqueline në karvanin presidencial nëpër rrugët e Dallas, Texas më 22 nëntor, 1963. Lee Harvey Osëald u arrestua 45 minuta më pas të shtënave kundrejt Kenned-it. Pas disa orësh të marrjes në pyetje pa ndjekur shumë procedura ai u akuzua për vrasje. Më pas u vra nga Jack Ruby në garazhin e ndërtesës së policisë më 24 nëntor para qindra gazetarëve. Më 29 nëntor, Presidenti Lyndon B. Johnson krijoi një komision të quajtur "Ëarren" për të hetuar rreth vrasjes. Komisionin e drejtonte Earl Ëarren, Shefi i Drejtësisë i Shteteve të Bashkuara, dhe gjeti se Osëald ishte vrasësi i vetëm dhe se ai e bëri vrasjen nga kati i gjashtë i një ndërtese që shërbente si depozituese librash shkollor. Arma të cilën kishte përdorur ishte një pushkë italiane Mannlicher-Carcano.

8. Kafka e kristaltë

Misteri i kafkës së kristaltë përkon shumë vite mbrapa. Në 1881, dy mercenarë amerikanë kanë gjetur dy kafkat e para të kristalta. Trembëdhjetë kafka kristali, janë gjetur gjithsej në të gjithë Evropën Qendrore dhe Jugore. Ndoshta kafka më e famshme e gjetur ndonjëherë është kafka "Mitchel-Hedges", e gjetur nga një shtatëmbëdhjetë vjeçare Anna Mitchel Hedges teksa shoqëronte babain e saj Albert Frederick Mitchel Hedges në një ekspeditë. Më pas u zbulua se Mitchel Hedges e kishte blerë kafkën në një ankand në Sotheby të Londrës në vitin 1943. Një tjetër kafkë e famshme është dhe ajo e Muzeut Britanik e blerë në Meksikë.

7. Varri i Vlad Draculës

Konti Drakula, "Drakula i vërtetë" ishte në fakt një princ i Ëallachia (tani pjesë e Rumanisë). Një mbrojtës i mirë kundër turqve, ai është portretizuar si një hero, patriot dhe një horr i pamëshirshëm. Vlad Drakula ishte një sundimtar i egër i cili ka torturuar në mes 40.000 dhe 100.000 të armiqve të tij, të dy turqit dhe bashkatdhetarët e tjerë që përbënin një kërcënim për pushtetin e tij. Ai u vra në betejën kundër turqve pranë Bukureshtit në 1476. Turqit pas e vranë ja prenë kokën dhe ja dërguan sulltanit të Perandorisë Osmane, Mehmetit II. Pjesa tjetër e trupit të tij ende nuk dihet se ku është.

6. Dhoma e qelibartë

Kjo dhomë mahnitëse është ndërtuar në 1701 nga mbreti i parë i Prusisë, por u zhvendos shpejt në Rusi si një dhuratë për Pjetrin e Madh. Dhoma është më shumë se 55 metra katrorë dhe për ta ndërtuar u deshën 10 vjet dhe gjashtë ton qelibar balltik. Kur ushtria e Hitlerit shkeli në Bashkimin Sovjetik, kuratorët u përpoqën të lëvizin dhomën edhe një herë, por qelibari ishte bërë i brishtë, kështu që ata e fshehën atë prapa një sfondi të thjeshtë. Megjithatë, nazistët e dinin se ku mund të shikonin për punën e famshme të artit dhe ushtarët e shkatërruan dhomën në mënyrë që ta çonin atë në Königsberg. Kalaja e Königsbergut u bombardua rëndë nga Mbretëria e forcave ajrore gjatë një lufte. Sipas disa raporteve dhoma e qelibatrë arriti ti mbijetojë luftës por nuk është parë më kurrë që nga ajo kohë.

5. Gjëagjëza e njeriut të pakuptueshëm

Kur mendon për "Sfinks-in", të gjithë menjëherë mendojnë për Sfinks-in e Madh në Giza, por Sfinks ishte një simbol i fuqishëm në Greqi dhe Siri. Në fakt origjina e gjëagjëzës së Sfinks-it vjen nga legjendat e vjetra greke. Sipas grekëve të lashtë, në qoftë se një njeri kalon në rrugën e Sfinks-it do të pyesin: "Cila është krijesa që ecën me katër këmbë në mëngjes, dy këmbë në pasdite dhe tre në mbrëmje?" Në qoftë se ata nuk mund të përgjigjen, Sfinks do ti hajë ata, megjithatë, në qoftë se ato

japin përgjigje të saktë, Sfinks do të shkatërrojë veten. I vetmi person që i ka mbijetuar kësaj procedure thuhet se është heroi grek Oudipus, i cili i është përgjigjur "njeriu". Por thuhet se Sfinks vazhdoi me pyetje të tjera.

4. Rrjepësi Jack

Një nga rastet e vrasjeve të pazgjidhura në botë, është Jack Ripper, i cili ka futur frikë në zemër të Viktorias në Londër dhe endet në imagjinatën tonë edhe sot. Midis muajve gusht dhe nëntor të vitit 1888, pesë prostituta u vranë në Ëhitechapel, një zonë në lindje të Londrës. Ndonëse viktoria në Londër ishte një vend i pasur, pjesa e Lindjes ishte një zonë shumë e varfër e qytetit. Shumica e shtëpive ishin refugjatë hebrej nga Rusia, Polonia dhe Rumania. Ëhitechapel gjithashtu kishte shkallën më të lartë të krimit në qytet. Çdo gjë në lidhje me vrasjet duket të jetë një mister, nga identiteti i vrasësit e deri në letrat që u dërguan në polici. Edhe numri i viktimave është ende një mister. Përgjithësisht është pranuar se numri i viktimave të Jack Ripper ishte pesë. Disa të tjerë thonë se ishin katër, por në fakt e gjitha kjo mbetet një mister. Por në fakt historia e Jack Ripper-it kishte një efekt të vërtetë, jo vetëm në pjesën tjetër të Londrës, por edhe në të gjithë Perandorinë Britanike.

3. Arka e marrëveshjes

Arka e marrëveshjes ka mahnitur njerëzit që kur u përmend më parë në Bibël në Eksodin 25. Perëndia udhëzoi që të ndërtohej një faltore ku të gjithë Izraelitët mund të adhuronin Perëndinë, dhe brenda saj do të jetë një dhomë e veçantë e quajtur "i shenjti i të shentëve" dhe pikërisht aty do të vendosej arka. Dhoma ishte e bërë nga druri i akacies e mbuluar në ar. Ajo përmban tri objekte të çmueshme, dy pllaka prej guri të cilat përmbajnë "Dhjetë Urdhërimet", një shufër të Aaron-it dhe një tenxhere të artë. Është përfolur gjithashtu se vet perëndia ka banuar midis krahëve të këtij vendi. Arka nuk ishte vetëm në qendër të besimit të Izraelit, por ajo gjithashtu kishte kompetenca mbinatyrore dhe ishte në gjendje të mundte armiqtë e tyre.

2. Mbreti Artur

A ekziston me të vërtetë një nga mbretërit më të famshëm apo është vetëm një legjendë në mënyrë që të frymëzohen trupat anglez? Për herë të parë është përmendur nga një klerik i Wellsit i quajtur Nennius në shekullin e nëntë. Megjithatë, kontributi më i plotë i është njohur historisë së mbretërve të Britanisë, e cila daton në shekullin e dymbëdhjetë. Aty pohohej se mbreti Artur ishte i patejkalueshëm në pushtet dhe në diplomaci, një mbret i madh luftëtar i cili drejtoi Uellsin, Skocin, Irlandën, Norvegjin, Danimarkën, Gjermanin, Anglinë dhe Galin. Përflitet që historia e tij të jetë e rreme por kjo nuk shmang dashurinë që njerëzit kanë për legjendën e mbretit Artur.

1. Ishulli i humbur i Atlantit

Një nga misteret më të vjetër në botë, legjenda e Atlantit ka hutuar njerëzimin që nga kohët e lashta. Sipas filozofit grek Platonit, Atlanti ishte një ishull i madh diku në perëndim të Gjibraltarit dhe në shtëpinë e një qytetërimi tepër të avancuar të njohur si Atlanteans. Platoni e përshkroi Atlantin si një vend me bukuri të mëdha, me një kompleks pallati në qendër të tri kanaleve me unazë. Ai tha se çdo mbret që trashëgonte pallatin do të shtonte në të një kat, duke u përpjekur të kapërcejë paraardhësin e tij dhe duke bërë kështu atë një pallat që ka të ndërthurura bukurinë dhe pasurinë. Vendasit ishin bekuar me pasuri, por në të njëjtën kohë ata ishin tepër ambicioz, vazhdimisht duke kërkuar pushtet. Atlantis është thënë se ka takuar fundin e saj kur u godit nga një tërmet gjigant dhe ka përfunduar në thellësi të detit.

Norvegji, spirale drite misterioze ne qiell



Norvegji, spirale drite misterioze ne qiell

Disa drita me ngjyre blu dhe forme spiraleje te vrejtura ne qiellin e Norvegjise kane lene me goje hapur mijera banore te zones.

Fenomeni i cuditshem ka ndodhur te merkuren ne mengjes ne provincen e Trondelag deri ne Finnmark.

Shume persona qe kane pare episodin, kane krijuar nje psikoze te vertete mase qe u ushqye nga televizionet lokale.

Per ekspertet behet fjale per leshimin e deshtuar te nje rakete ruse.

Fenomeni ka filluar kur nje drite misterioze qe eshte shfaqur nga pas nje mali, eshte ndalur ne mes te qiellit dhe me pas ka filluar te levize ne forme spiraleje.

Brenda pak sekondash spiralja gjigande ishte e dukshme per disa kilometra ne qiellin e veriut te vendit.

Fenomeni i pashpjegueshem ka zgjatur per pak minuta parpara se te zhdukej plotesisht.

Per disa deshmitare, fenomeni misterioz eshte nje meteorit, te tjeret betohen se behet fjale per UFO.

Nderkohe perforcohet hipoteza se behet fjale per deshtimin e leshimit te nje rakete ruse nga nje nendetese ne Detin e Bardhe.

Fenomenet që nuk kanë shpjegim



1. Lidhja trup-mendje

Shkenca mjekësore deri më tani ka arritur vetëm në fillim të të kuptuarit të mënyrave sesi mendja ndikon trupin. Një shembull është efekti Placebo, sipas të cilit njerëzit mendojnë se iu lehtësua një simptomë mjekësore ose vuajtje, vetëm duke besuar se një kurë është efektive, ndërkohë që në të vërtetë kura është një farsë. E në rrjedhim të kësaj, është e cuditshme sesi aftësia e trupit për të shëruar vetveten është shumë më e mahnitshme sesa cdo gjë tjetër që mund të shpikë mjekësia moderne.

2. Fuqitë psikike dhe PEN

Fuqitë psikike dhe Perceptimi Ekstra-Ndijor (PEN), renditen ndër dhjetë gjërat më të pashpjegueshme, për faktin se besimi në to është shumë i përhapur. Hulumtuesit kanë testuar njerëz që pretendojnë të kenë fuqitë psikike, ndonëse rezultatet nën kushtet e kontrolluara shkencore deri më tani kanë qenë negative ose të paqarta. Disa studiues argumentojnë se fuqitë psikike nuk mund të provohen, ose zvogëlohen në prani të skeptikëve ose shkenctarëve. Nëse kjo është e vërtetë, shkenca nuk do të jetë në gjendje kurrë të provojë apo të hedhë poshtë ekzistencën e fuqive psikike.

3. Eksperienca pranë-vdekjes dhe jeta pas vdekjes

Njerëzit që ndonjëherë janë gjendur pranë vdekjes, kanë raportuar përvoja të ndryshme mistike (për shembull duke shkuar në një tunel dhe dalin në një dritë, duke u bashkuar me të dashurit e tyre, ndejnë paqe, etj), të cilat mund të sugjerojnë një ekzistencë përtej varrit. Por përvojat përtej varrit askush nuk është kthyer të na i tregojë. Skeptikët sugjerojnë se përvojat pranë-vdekjes mund të shpjegohen si halucinacione natyrore dhe të parashikueshme të trurit të traumatizuar, por ende nuk ka asnjë mënyrë për të ditur me siguri se çfarë i shkakton këto përvoja.

4. UFO-t

Tashmë nuk ka dyshim se UFO-t (Unidentified Flying Objects) ekzistojnë. Shumë njerëz kanë parë gjëra në qiell që nuk mund t'i identifikojnë, duke filluar nga aeroplanët te meteorët. Nëse këto janë apo jo anije alienësh, është një çështje tjetër. Por distancat e studiuara të këtyre objekteve, të japin të dhëna për "të huaj" të ardhur nga Universi drejt Tokës. Por, pavarësisht nga hetimet e kujdesshme rreth UFO-ve, ende mbeten fenomene të panjohura.

5. Deja Vu

Deja-vu është një frazë frëngjisht që ka kuptimin "e kam parë njëherë" dhe i referohet një ndjenje të veçantë dhe misterioze që është përjetuar në një sërë rrethanash të veçanta më parë. Dikush për shembull po viziton për herë të parë një ndërtesë në një vend të huaj, por i duket shumë ambjent familjar, sikur e ka shikuar edhe herë tjetër. Disa njerëz i shpjegojnë këto fenomene si përvoja psikike të jetës së mëparshme, shpirtit para lindjes. Disa të tjerë i japin më shumë shpjegime natyrore, por prapë nuk kanë arritur t'i japin një shpjegim të duhur.

6. Fantazmat

Që nga "Makbethi" i Shakespeare e deri tek shfaqjet e ditëve të sotme si "NBC Medium", shpirtrat e të vdekurve kanë bërë zënë gjithmonë vend të vecantë në folklorin dhe kulturën njerëzore. Shumë njerëz kanë raportuar se kanë parë hije të të huajve, apo të të afërmeve të vdekur. Megjithëse prova përfundimtare për ekzistencën e fantazmave mbetet e pakapshme, dëshmitarë të bindur vazhdojnë të raportojnë se kanë parë, fotografuar, dhe madje komunikuar fantazmat. Studiuesit e fantazmave ende shpresojnë se një ditë që i vdekuri mund të kontaktojë me të gjallin në këtë mënyrë, por deri atëherë, fantazmat i klasifikojmë tek fenomenet e pashpjegueshme.

7. Zhdukjet misterioze

Njerëzit zhduken për arsye të ndryshme. Shumica arratisen, disa pësojnë aksidente, disa rrëmbehen, disa vriten, por këto kategori zakonisht janë gjetur. E njëjta gjë nuk ndodh me zhdukjet misterioze. Sjellim ndërmend: që nga ekuipazhi i Marie Celeste te Jimmy Hoffa, Amelia Earhart, dhe Natalee Holloway, disa njerëz duket se janë zhdukur pa lënë gjurmë. Kur personat e humbur janë gjetur, kjo ka ndodhur gjithmonë falë policisë, denoncimeve apo dëshmitarëve. Por kur provat mungojnë dhe s'ka asnjë shenjë, as policia dhe shkenca ligjore nuk mund të zgjidhin krimin.

8. Intuita

Sido që ta quajmë atë: ndjenjë e brendshme, shqisë e gjashtë, apo gjithcka tjetër, të gjithë e kemi përjetuar në një kohë apo një tjetër. Sigurisht, këto lloj ndjenjash që vijnë nga brenda qënies tonë, shpesh janë të gabuara, por në më të shumtën e rasteve rezultojnë të sakta. Psikologët vërejnë se njerëzit, në mënyrë të pavetëdijshme marrin informacion rreth botës që na rrethon, duke bërë që të na duket si informacion i njohur në momentin që përballemi me të, por duke mos ditur se kur dhe si e kemi mësuar. Megjithatë, kjo e psikologjisë konsiderohet vetëm një pjesëz e përgjigjes për të shpjeguar intuitën.

9. Këmbëmédhenjtë

Për dekada me radhë, bisha të mëdha, leshatore, të ngjashme me njerëzit, të quajtura Këmbëmédhenjtë (Bigfoot) janë raportuar herë pas here nga dëshmitarë në të gjithë Amerikën. Pavarësisht mijëra Këmbëmédhenjve që mund të ekzistojnë si popullsi dhe mund të mbarështohen, ende nuk është gjetur asnjë trup i tyre. Asnjë i tillë nuk është vrarë nga një gjahtar, goditur për vdekje nga një makinë me shpejtësi, apo edhe vdekur nga shkaqe natyrore. Në mungesë të provave si dhëmbët dhe kockat, janë marrë si prova të ekzistencës së tyre në Tokë vetëm sytë e dëshmitarëve, apo foto e filmime të paqarta. Mëgjithatë, duke mos patur prova të qarta, shkencë konkludon për Këmbëmédhenjtë se ose nuk ekzistojnë dhe janë dëshmi të sajuaara, ose janë krijesa që rrinë larg syve njerëzorë, ose... janë fenomene të pashpjegueshme.

10. Gumëzhitjet në Taos

Disa nga banorët dhe vizitorët e qytetit të vogël të Taos, New Mexico, për vite me radhë kanë treguar se janë bezdisur dhe habitur nga një frekuencë e ulët gumëzhitjesh në ajrin shkretinor. Për cudi, këto gumëzhitje në Taos i kanë raportuar vetëm 2% nga popullsia vendase, ndërsa vizitorët i kanë ndjerë dhe raportuar shumë. Disa besojnë se gumëzhitjet shkaktohen nga një akustikë e jashtëzakonshme, të tjerët dyshojnë për histori masive apo ndonjë sekret, ndonjë qëllim i keq. Por sido që të besohet për këto lloj gumëzhitjesh, natyrore apo psikologjike, ende askush nuk ka mundur t'i japë një shpjegim të saktë.

Krijesat e çuditshme dhe Fenomenet paranormale të kohëve moderne

Nga njerëzit e vegjël, njeriu me kokë qeni e deri tek njerëzit hije

Shumë prej nesh janë të njohur me pretendime të ndryshme për fenomene paranormale, pavarësisht faktit nëse jemi skeptikë apo i besojmë. Qenie të tilla si fantazmat, kafshët misterioze gjithnjë kanë ndjekur ndërgjegjen tonë kolektive. Ndër çuditë më të mëdha që mund të ekzistojnë mes nesh, ka disa prej ngjarjeve që edhe pse s'mund të konsiderohen të reja, vazhdojnë të tërheqin vëmendjen. Qëkur zbulimi se një racë krijesash të vogla mund të ketë ekzistuar në tokë, shkencë ka ri-ekzaminuar mundësinë se njerëz të tjerë të vegjël mund të mos jenë koncept krejtësisht mitik. Duke lënë mënjane shkencën, gjithnjë ka pasur nga ata që insistojnë se krijesa të vogla humanoide ekzistojnë mes nesh. Kohët e fundit ka pasur njerëz që kanë deklaruar se kanë parë krijesa të vogla në vende të izoluara, me tiparet e njeriut.

Grabitqarët e mëdhenj janë zogj që kërkojnë për ushqim ose ushqehen me gjëra të ngordhura. Ato janë zakonisht më të mëdhenj se zogjtë normalë dhe kanë një fiziologji

të caktuar, si thonj të fuqishëm që i ndihmojnë të shqyejnë prenë e tyre. Kohët e fundit, ka pasur njerëz që kanë raportuar se kanë parë zogj grabitqarë me përmasa shumë të mëdha. Shumë persona thonë se ato duken si zogjtë prehistorikë të përshkruar në libra dhe me lëkurë gjarpri.

Rrëshqitjet e kohës dhe koha e humbur janë eksperiencia aspak të këndshme. Ato janë hamendësuar si takime jashtëtokësore, zhvendosje dimensionale ose goditje truri. Raportimet më mahnitëse janë ato të më shumë se një personi për përjetimin e kapërcimeve të kohës. Sipas kësaj teorie, rrëshqitjet e kohës ndodhin kur dikush nisët për një udhëtim në një rrugë të njohur dhe udhëtimi duket normal, por në përfundim personat zbulojnë se kanë mbërritur në destinacion shumë më herët se çdo ishte e mundur normalisht. Chupacabra është përshkruar si një krijesë në formë qeni me dhëmbë të mëdhenj. Fillimisht thuhet se është parë në Puerto Riko në vitin 1990 dhe më pas është parë në Amerikë dhe Meksikë. Nganjëherë dëshmitarët raportojnë se këto kafshë kanë një të ecur prej kanguri. Thuhet se kjo kafshë u thith gjakun bagëtive natën deri sa ato ngordhin. Ngjashmëria me vampirët i ka terrorizuar njerëzit duke hamendësuar një sulm të mundshëm ndaj tyre. Pyjet janë vende misterioze, plot me jetë të panjohur dhe shfaqin rrezik për këdo. Pyjet janë vende të frikshme sipas legjendave popullore. Por në kohët moderne a mund të krijohet natyra një panik të tillë të pajustificuar? Ka nga ato, eksperiencia e të cilëve bën të mendosh se natyra ka inteligjencë dhe nuk është gjithmonë e dashur me njerëzit. Ka njerëz që thonë se karakteristika kryesore është paniku, të cilin njerëzit e përshkruajnë me një qetësi të pazakonshme në pyll.

Sekretet më të mëdha të hapura për publikun Churchill-i dhe ekzekutimi i Hitlerit

Kryeministri britanik i kohës së luftës, Winston Churchill kishte në plan ta ekzekutonte Hitlerin në karrige elektrike, nëse lideri nazist do të binte në duart e forcave aleate. Është ky një prej sekreteve të zbuluara shumë vite më vonë. Dokumente të zbardhura, zbulojnë se Churchill ishte kundër planeve të aleatëve për gjyqet e luftës. Sipas dokumenteve, ai donte të ekzekutonte të gjitha figurat udhëheqëse naziste duke përfshirë këtu dhe Hitlerin, të cilin e konsideronte si "zembereku i së keqes" dhe një "gangster". Faktet për urrejtjen e thellë të Churchill ndaj Fyhrerit janë shfaqur nga disa dokumente që janë bërë publike nga Arkivat Kombëtare në Britani. Në shënimet e sekretarit të kabinetit, Norman Book shfaqen mendimet dhe diskutimet gjatë takimeve më të rëndësishme në kohën e luftës. Kryeministri më pas thekson metodën e tij të preferuar për ekzekutimin e Hitlerit: karrigen elektrike. Ai madje dhe bën shaka me kolegët e kabinetit duke u shprehur se një të tillë mund ta merrnin hua nga SHBA.

Masakra "My Lai"

Masakra "My Lai" ishte një seancë vrasjes masive të rreth 504 qytetarëve të paarmatosur në republikën e Vietnamit. Ato ishin thuajse krejtësisht civilë dhe shumica e tyre gra dhe fëmijë. Masakra u krye nga forcat e ushtrisë amerikane më 16 mars 1968. Përpara se të vriteshin disa prej viktimave u përdhunuan, torturuan dhe gjymtuan. Gjashtë muaj më vonë, Tom Glen, një ushtar 21-vjeçar amerikan i shkroi një letër gjeneralit Creighton Abrams, Komandanti i ri i Përgjithshëm i forcave të armatosura

amerikane në Vietnam, ku përshkruante brutalitetin e rregullt ndaj civilëve vietnamezë. Letra ishte e detajuar dhe përmbajtja u bënte jehonë ankesave të tjera të njëjta nga ushtarët. Colin Powell, në atë kohë një major 31-vjeçar u ngarkua të hetonte letrën dhe në një raport ai shkruante: "...marrëdhëniet mes ushtarëve amerikanë dhe vietnamezëve janë të shkëlqyeshme". Në vitin 2004, Powell i tha Larry King në "CNN": "Unë shkova atje pasi My Lai kishte ndodhur. Në luftë, këto gjëra të tmerrshme ndodhin herë pas here, por ato duhet të dënohen".

Operacioni "Paperclip"

I bindur se shkencëtarët gjermanë do të ndihmonin SHBA-në, presidenti Harry Truman ra dakord në shtator 1946 të autorizonte projektin "Paperclip". Ky program synonte të merrte në SHBA shkencëtarë gjermanë të zgjedhur, të cilët do të punonin për Amerikën gjatë Luftës së Ftohtë. Më i famshmi i këtyre shkencëtarëve ishte Werner Von Braun, njeriu që ishte truri i krijimit të fotove të hënës, si dhe anëtar i shumë organizatave naziste. Ai gjithashtu kishte një rang të lartë në "SS". Dosja e tij e hershme e inteligjencës e përshkruante si një "rrezik të sigurisë". Presidenti Truman kishte kërkuar që shkencëtarët gjermanë të mos ishin të përzier me nazizmin dhe fillimisht mendohej që ata të qëndronin për një kohë të shkurtër, por duke parë njohurinë dhe ekspertizën e tyre departamenti i Luftës vendosi t'i mbante. Në vitin 1958, ky operacion ishte informacion i zakonshëm për të gjithë dhe madje është përmendur hapur në një artikull të revistës "Time".

Templarët dhe Vatikani

Në tetor të vitit 2007, Vatikani publikoi disa dokumente sekrete për procesin gjyqësorë të kalorëseve templarë, duke përfshirë një dorëshkrim që dëshmonte se papa Klementi V e kishte shfajësuar urdhrin mesjetar nga herezia. Dokumentet e bëra publike nga Vatikani riprodhonin një dokumentacion të plotë të shqyrtimeve papnore të kryera pasi mbreti Filip IV i Francës arrestoi dhe torturoi liderët templarë në vitin 1307, me akuzën e herezisë dhe imoralitetit. Sipas faqes në internet të Vatikanit, pergamena dëshmon se papa Kelementi fillimisht i çliroi nga akuza për herezi templarët, pavarësisht se ai i konsideroi fajtorë për imoralitet dhe ai gjithashtu planifikonte reformimin e urdhrit. Sidoqoftë, presioni i mbretit Filip e detyroi papën të kthente mbrapsht vendimin e tij dhe të shuante urdhrin në vitin 1312.

Krijesat e vogla

Qëkur zbulimi se një racë krijesash të vogla mund të ketë ekzistuar në tokë, shkenca ka ri-ekzaminuar mundësinë se njerëz të tjerë të vegjël mund të mos jenë koncept krejtësisht mitik. Duke lënë mënjane shkencën, gjithnjë ka pasur nga ata që insistojnë se krijesa të vogla humanoide ekzistojnë mes nesh. Kohët e fundit ka pasur njerëz që kanë deklaruar se kanë parë krijesa të vogla në vende të izoluar, me tiparet e njeriut.

Grabitqarë të mëdhenj

Grabitqarët e mëdhenj janë zogj që kërkojnë për ushqim ose ushqehen me gjëra të ngordhura. Ato janë zakonisht më të mëdhenj se zogjtë normalë dhe kanë një fiziologji të caktuar, si thonj të fuqishëm që i ndihmojnë të shqyejnë prenë e tyre. Kohët e fundit, ka pasur njerëz që kanë raportuar se kanë parë zogj grabitqarë me përmasa shumë të mëdha. Shumë persona thonë se ato duken si zogjtë prehistorikë të përshkruar në libra dhe me lëkurë gjarpri.

“Doppelgangers”

Kjo është një gjermane që do të thotë kopja e ekzakte e një personi. Në kohët moderne personat që i besojnë teorive paranormale thonë se kanë parë një person në një vend të caktuar, për t'i takuar më vonë në një vend krejtësisht tjetër. Disa njerëz madje pretendojnë se në mënyrë të padiskutueshme kanë parë veten e tyre, të veshur me të njëjtat rroba duke theksuar se “kopja” e tyre është shfaqur njësoj e habitur.

Rrëshqitjet e kohës

Rrëshqitjet e kohës dhe koha e humbur janë eksperiencia aspak të këndshme. Ato janë hamendësuar si takime jashtëtokësore, zhvendosje dimensionale ose goditje truri. Raportimet më mahnitëse janë ato të më shumë se një personi për përjetimin e kapërcimeve të kohës. Sipas kësaj teorie, rrëshqitjet e kohës ndodhin kur dikush nis për një udhëtim në një rrugë të njohur dhe udhëtimi duket normal, por në përfundim personat zbulojnë se kanë mbërritur në destinacion shumë më herët se çdo ishte e mundur normalisht.

“Chupacabra”

Chupacabra është përshkruar si një krijesë në formë qeni me dhëmbë të mëdhenj. Fillimisht thuhet se është parë në Puerto Riko në vitin 1990 dhe më pas është parë në Amerikë dhe Meksikë. Nganjëherë dëshmitarët raportojnë se këto kafshë kanë një të ecur prej kanguri. Thuhet se kjo kafshë u thith gjakun bagëtive natën deri sa ato ngordhin. Ngjashmëria me vampirët i ka terrorizuar njerëzit duke hamendësuar një sulm të mundshëm ndaj tyre.

Paniku në pyll

Pyjet janë vende misterioze, plot me jetë të panjohur dhe shfaqin rrezik për këdo. Pyjet janë vende të frikshme sipas legjendave popullore. Por në kohët moderne a mund të krijojë natyra një panik të tillë të pajustificuar? Ka nga ato, eksperiencia e të cilëve bën të mendosh se natyra ka inteligjencë dhe nuk është gjithmonë e dashur me njerëzit. Ka njerëz që thonë se karakteristika kryesore është paniku, të cilin njerëzit e përshkruajnë me një qetësi të pazakonshme në pyll.

Njeriu me kokë qeni

Njeriu me kokë qeni është përfolur që prej kohëve të lashta. Ekzistenca e një krijese të tillë në kohët moderne duket e pabesueshme, por gjithsesi ka njerëz që pretendojnë se

kanë parë një të tillë. Shumë prej këtyre ngjarjeve thuhet se kanë ndodhur natën, pak raportime ka për ditën. Por ato që thonë se kanë parë një krijesë të tillë thonë gjithashtu se kanë parë një burrë me kokë qeni që ecën i qetë dhe indiferent rrugëve.

Njeriu si bastun i zi

Njeriu si bastun i zi është një tjetër qenie e kohëve moderne. Ai supozohet se është krejtësisht i zi dhe me një siluetë prej bastuni. Këto lloj krijesash thuhet se janë jashtëzakonisht të gjata. Koka e tyre është si një rreth i zi, pa tipare fytyre. Ato thuhet se janë krejtësisht dy-dimensionale. Zakonisht ato shihen natën, në mëngjes herët ose në muzg. Sipas “dëshmitarëve”, ato nuk habiten kur i shohin dhe me raste i kanë ndjekur ato që i kanë parë.

Njerëzit hije

Çfarë janë njerëzit hije? Askush nuk duket se e di me siguri, edhe ato që thonë që i kanë parë. Zakonisht ato janë figura të errëta, të cilët ecin papritur nëpër korridore, kalojnë nëpërmjet mureve, shfaqen në dhoma dhe zhduken menjëherë etj. Ato s’kanë asnjë qëllim, s’duket se shërbejnë si paralajmërues. A vijnë ato nga një dimension tjetër? Nga jeta e përtejme? Asgjë prej këtyre s’dihet, por dihet se ato që i shohin, s’i harrojnë më.

Fëmijët me sy të zinj

Nisi në vitin 1998 kur gazetari Brian Bethel rrëfeu se i ishin afruar dy djem të vegjël teksa hynte në makinë. Ato i kishin kërkuar që t’i dërgonte deri diku. Ai shpjegonte se ndjeu një panik të çuditshëm e ndërkohë ndihej i detyruar për t’u hapur derën djemve. Më pas kishte parë sytë e tyre krejtësisht të zinj, pa asnjë pjesë të bardhë. Që prej kësaj historie, njerëz të tjerë kanë raportuar takimin me fëmijë të tillë.

TE ZHDUKUR NE MENYRE MISTERIOZE

Të zhdukur ne mënyrë misterioze, për tu gjetur më pas me kujtesë krejtësisht të fshirë

Ne Kazan te Rusise, nje ekonomist u zhduk ndersa kthehej nga puna per ne shtepi, per tu shfaqur pas gjashte muajsh, nje mije kilometra

larg, nderkohe qe nuk arrinte te mbante mend asgje per veten.

Nje 15-vjeqar nga Lipetseki, i zhdukur teksa shkonte ne shkolle u gjet ne nje pyll prane Moskes, dhe nuk arrinte te kujtonte absolutisht asgje. Nje ushtar u zgjua ne nje spital dhe u tha mjekeve se nuk kujtonte dot as emrin e tij.

Ekonomisti, studenti e ushtari jane pjese e nje grupi prej 31 vetash, viktima te amnezise, qe gjate pese vjeteve te fundit u nenshtrohen rregullisht kurave ne Institutin Psikiatrik Serbski te Moskes.

Ndokush prej tyre ka arritur te rigjeje "kujtesen autobiografike", por askush nuk ka as idene me te mjegullt per ate qe mund t'i kete ndodhur gjate kohes kur eshte zhdukur. Eksperimente te sherbimeve secrete me psikofarmake te fuqishem?

Thjesht Mitomanë? Rrembime aliene?"

I kemi shqyrtuar te gjitha hipotezat", thote profesori Zurab Kekelidze, nendrejtori I institutit, gjate nje interviste per "Moskvski Komsomolets".

"Nuk vuajne nga asnje shqetesim mendor, nuk njoh asnje psikofarmak aq te fuqishem qe arrin ta beje kete efekt. Asnje e dhene nuk na ben te mendojme se behet fjale per ndonje trillium. Alienet. Fillimisht duhet provuar qe ekzistojne".

Edhe nje tjeter detaj i pashpjegueshem, thuajse te gjithë jane gjetur pa asnje fije kujtese prane nje hekurudhe. Edhe nje detaj tjeter i rendesishem: fenomeni eshte vene re thuajse vetem te meshkujt (vetem 3 femra).

Pacientet kane shume pak gjera te perbashketa me njeri tjetrin : moshë nga 16 ne 66vjet dhe te gjithë vijne nga shtresa te ndryshme shoqerore.

Instituti (I njohur ne epoken sovjetike, pasi aty trajtoheshin disidentet politik) mes te shtruarve ka edhe nje gjermano-rus, i zhdukur ndersa drejtonte makinën ne Gjermani dhe i zgjuar pa billet ne nje tren prane qytetit Vologda, i vendosur rreth 500km larg Moskes.

"Nuk e di kush jam, nuk e kam idene se ku po shkoj" – vetem keto fjale diti te thoshte. Me pas u zbulua se nuk qe ne gjendje te thoshte asnje fjale ne gjermanisht, gjuhe qe e njihete ne menyre te persosur. Ne koke i kishte mbetur vetem rusishtja qe fliste kur jetonte ne Kazakistan.

Gjermani u kthye ne Gjermani, ku iu desh te mesonte nga zeroja gjuhen e Getes, per te mundur te komunikonte me gruan dhe femijet.

Ndersa ushtari u dashurua me nje infermiere, me te cilen edhe u martua, nderkohe qe nuk pranon ne asnje menyre te kthehet ne shtepi, ku thote se "ka vetem te huaj".

Sinjale misteriozë

A mund të jemi kaq arrogantë sa të mendojmë se jemi i vetmi përjashtim në pafundësinë e universit? Çfarë do të ndodhte nëse do të intercepionim një sinjal apo një mesazh me origjinë aliene?

Ndërkohë që bota shkencore është e ndarë në debat, teologjia katolike pranon mundësinë e formave të jetës në botë të tjera. Astronomi jezuit, Atë Hoze Gabriel Funes pohonte në 13 maj të vitit që kaloi në një intervistë të dhënë për "Observatorin" roman se "është e mundur që në ndonjë qoshe të universit të ekzistojnë planete të ngjashëm me Tokën, ku ka patur një zhvillim të jetës". Ideja e formave inteligjente të jetës, të ngjashme me tonën, nuk bie ndesh me vizionin kristian, por përkundrazi, ajo mbështet idenë e një Ati Krijues të përbashkët, siç është shprehur në të kaluarën edhe Don Piero Koda, Minsinjor Korado Balduçi, si dhe Atë Xhorxh Koin.

IMPULSI MISTERIOZ

Një impuls i quajtur SHGB02+14A ka udhëtuar nëpër frekuencën 1420 MhZ. Është kjo gjëja më e rëndësishme që është zbuluar nga radioteleskopi i Arecibos në Porto Riko kur në shkurt të vitit 2003 nisi projekti SETI (Search for Extra Terrestrial Intelligence - një organizatë shkencore private), apo më saktë, një program shkencor që e ndan hemisferën qiellore në 200 pjesë, i pikas, i studion, i analizon. Sinjali vjen nga 1000 vite dritë larg Tokës dhe fuqia e tij e lëshimit rezulton e qëndrueshme ndryshe nga të tjerë që, deri tani, janë humbur nëpër zhurmat e fundit të universit.

Sipas disa shkencëtarëve, nuk bëhet fjalë për fenomene natyrorë, por për dikë që nga qielli përpiqet të vendosë një kontakt me ne. Debati mbetet i hapur, ndërkohë që bota shkencore është e ndarë ndërmjet filoalienëve dhe skeptikëve. Vala e radios vjen nga një pjesë e qiellit ku nuk duket të ketë galaksi. Frekuenca e lëshimit përkon me një prej notave parësore me të cilat hidrogjeni thith dhe lëshon energji. Sipas studimeve të parë, sinjali nuk duket se vjen nga burime natyrorë por duket se është i ndërtuar artificialisht. Diomethënë: I ndërtuar nga një inteligjencë aliene, e cila është në gjendje të përgatisë një urë transmetimi drejt pafundësisë në pritje që dikush nga ana tjetër e qiellit ta kapë sinjalin dhe të përgjigjet. Tani pritet momenti kur ai të rishfaqet dhe atëherë e gjithë kjo do të bëhet vërtetë interesante. Ndërkohë, mbeten të gjithë pikëpyetjet mbi këtë çështje.

ART DHE UFO

Nëse diçka reale ka ndodhur vërtetë, atëherë duhet të ekzistojnë patjetër gjurmët në kujtesën kolektive të njerëzimit. Vetëm kështu do të shpjegoheshin misteret që përmbahen në artin e çdo epoke dhe çdo vendi. Në ikonografinë klasike gjenden figura të ndryshme në brendësi të veprave të krijuara e me autorë të ndryshëm, që riprodhojnë objekte të çuditshëm të ngjashëm me UFO-t. Ndër veprat që kanë më shumë lidhje me këtë argument mund të përmenden "Tebaida" e Paolo Uçelos, e pranishme në Galerinë e Akademisë së Firences. Piktura përmban skena të ndryshme të jetës në një manastir: poshtë në të majtë, Virgjëresha shfaqet në San Bernardo; sipër, një grup murgjish fshikullohen pranë një Kryqi; në qendër, në një shpellë të madhe është paraqitur Shën Zheromi teksa lutet përpara një tjetër kryqi me Krishtin të kryqëzuar, ndërkohë që lart, Shën Francesku, i gjunjëzuar pret stigmatat. Në zonën e poshtme dhe djathtas është paraqitur ndoshta predikimi i Shën Romualdos. Po çfarë është ai objekti i kuq në shpellë, në qendër, në të djathtë të kryqit?

Një tjetër vepër është "Lajmërimi" i Karlo Krivelit, e pranishëm në Londër, në Galerinë Kombëtare. Këtu paraqitet një rreze që zbret nga qielli dhe që mbërrin tek Madona. Ajo rreze nisët pikërisht nga një objekt fluturues i paidentifikuar, me formë disku që gjendet mes reve. Rrezja që godet Madonën (dhe që nga ana e saj dëgjon fjalët e Engjëllit) shfaqet në shumë vepra të tjera të artit mesjetar dhe të rilindjes, por mbi të gjitha në Lajmërimet e shumtë të Pagëzuarve të Krishtit.

Më tej, "Lindja e Krishtit", e Bernardino di Betos, i quajtur Pinturikio. "Po të ngresh sytë në qiellin e zyrtë, pak më sipër relieveve shkëmborë në horizont... Konturet dhe ngjyra e bërthamës përshkruajnë një sferë jo tamam të rregullt, me

ngjyrë gri të hapur dhe në dukje metalike, e cila lëshon një sasi drite, duke e bërë të rrethohet nga një aureolë ngjyrë të verdhë në portokiall".

Dhe duhet të përmendim edhe Madonën me Fëmijën e Shën Xhovanit, e pranishme në Firence. Vepër e Sebastiano Mainardit ose Jakobo de Selaios, kjo pikturë paraqet një personazh që, me një dorë në ballë sheh drejt një objekti në qiell. Me të është edhe një qen, i cili edhe ai sheh drejt një objekti të çuditshëm. Në Ungjillin sipas Lukës: "Në atë zonë kishte disa barinj që natën rrinin zgjuar për të ruajtur bagëtinë e tyre. Një engjëll i Zotit u shfaq para tyre dhe lavdia e Perëndisë i mbushi me dritë. Ata i mbërtheu paniku, por engjëlli u tha: "Mos u trembni, kam për t'ju dhënë një lajmërim të gëzueshëm, për të gjithë: sot ka lindur në qytetin e Davidit një shpëtimtar, që është Krishti..."

Sigurisht, nuk mund të flitet për prova, por vetëm për dyshime, tregues apo interpretime që u përkasin fesë, shërbimeve të fshehtë apo dëshmime personale. Por asnjë element të së vërtetës. Atëherë, si mund të interpretohen këto legjenda që qarkullojnë prej dhjetëra vitesh dhe që në veprat e çdo epoke gjejnë gjurmë evidente të shfaqjes së jashtëtokësorëve? Duket sikur njeriu dëshiron që me çdo kusht të zbulojë ekzistencën e një qenieje aliene.

TEORITË

Në vitin 1961, Akademia Kombëtare e Shkencave në SHBA organizoi një kongres për të diskutuar orientimin në studimet hapësinore. Ishte hera e parë që komuniteti shkencor përballej seriozisht me problemin e kërkimeve të sinjaleve të qytetërimeve jashtëtokësorë. Në atë rast, astronomi Frank Drake paraqiti një ekuacion, i cili ishte i destinuar të shndërrohej në bazën e çdo lloj studimi të ekzistencës së alienëve.

$$N = R \cdot f_p \cdot n_e \cdot f_l \cdot f_i \cdot f_c \cdot L$$

Ky ekuacion ishte një tentativë për të vlerësuar shkencërisht numrin e qytetërimeve jashtëtokësorë të pranishëm në galaksinë tonë dhe në gjendje të vendosin një kontakt me tokën.

N përfaqëson numrin e këtyre qytetërimeve, numër që korrespondon me produktin e fijeve të gërmave që ndodhen prapa një sinjali.

R është përqindja e formacioneve yjorë në Rrugën e Qumështit.

f_p është fraksioni i yjeve që kanë planetë; "ne" është numri i planetëve për sistem diellor që janë në gjendje të kenë forma jete; "fl" është ajo pjesë e planetëve që praktikisht ka zhvilluar forma jete; "fc" është pjesa e qenieve inteligjente që janë në gjendje të komunikojnë; fm është pjesa e qenieve inteligjente që janë në gjendje të arrijnë dhe kolonizojnë më shumë planete; L është vlerësimi i kohëzgjatjes së këtyre qytetërimeve të zhvilluar.

Rëndësia e ekuacionit të Drake qëndron në faktin që i ka dhënë dinjitet shkencor një pikëpyetjeje të madhe që përndryshe do të kish mbetur objekt ekskluziv kultesh, legjendash metropoiltane dhe mitizimesh. Vëmendja që gëzoi ekuacioni Drake në komunitetin shkencor lejoi nisjen e SETI-t. Ky projekt kërkimesh bazohet në idenë që qytetërimet alienë teknologjikisht të përparuar mund të zbulohen duke interceptuar sinjalet e tyre në valë radioje. Deri tani, asnjë nga eksperimentet e shumë të SETI nuk ka zbuluar diçka që të mund të konsiderohet si një sinjal komunikimi ndëryjor. Frank Drake ka thënë se në galaksinë tonë janë të paktën 10 332 qytetërime që janë në gjendje të vendosin një kontakt me ne, një numër që natyrisht e ka përlllogaritur falë ekuacionit të tij. Duke iu referuar deri në një farë mase ekuacionit të Drake, matematicieni i famshëm Aczel (autor i librave të ndryshëm shkencorë) ka konkluduar mes të tjerash se, cilido të

jetë numri, probabiliteti i ekzistencës së alienëve është baraz me njëqind përqind.

Në epokat përpara kësaj tonës është debatuar mundësia e ekzistencës së jashtëtokësorëve dhe janë marrë në konsideratë të gjithë problemet që buronin prej kësaj. Historiani Majkëll Krouka ka përlogaritur se që nga kohërat e grekëve të lashtë e deri në vitin 1917, janë shkruar afro 170 vëllime mbi këtë argument. Dhe pas vitit 1917, numërimi i vëllimeve të shkruar jo vetëm nuk është bërë, por do të ishte e pamundur.

Sipas shkencëtarëve, jeta rregullohet sipas tre parimeve: ai i uniformitetit të natyrës, i kompletimit dhe parimi kopernikas, ose mediokriciteti.

1. Ligjet e natyrës janë të njëjta në të gjithë universin. Si pasojë, proceset fizikë që kanë prodhuar jetën mbi tokë mund të verifikohen edhe diku tjetër.

2. Në natyrë, gjithçka që është e mundur ka prirjen të realizohet. Me fjalë të tjera: nëse asgjë nuk e pengon lindjen e jetës, jeta do të lindë.

3. Planeti tokë nuk zë një pozicion të veçantë dhe as nuk ka një status të veçantë në Univers. Është një planet tipik që rrotullohet përreth një ylli tipik në një galaksi tipike. Koperniku ka përfunduar se Toka dhe njerëzimi nuk janë në qendër të Universit. Aplikuar ky në çështjen e jetës në botë të tjera, parimi të bën të mendosh që nëse toka nuk është e veçantë nga pikëpamja astronomike, gjeologjike, fizike dhe kimike, atëherë nuk duhet të jetë e veçantë as nga pikëpamja biologjike.

Pastaj, a mund të jemi kaq arrogantë sa të mendojmë se jemi i vetmi përjashtim në pafundësinë e universit? Nëse merret e mirëqenë hipoteza që nuk ekziston asnjë Krijues me një tru të

denjë për këtë emër dhe që universi ka lindur pak rastësisht dhe pak në vijim të një shpërthimi të madh, Big Bang-ut siç e e quajnë fizikantët, nuk do të ishte e çuditshme që aksidenti i quajtur jetë po verifikohet vetëm një herë?

Nga cilido këndvështrim t'i qasesh këtij problemi, konkluzioni duket të jetë përherë i njëjtë: ndoshta vetëm për një faktor thjesht statistikor, nuk mund të jemi të vetëm në univers.

Çfarë impakti do të kishte mbi mënyrën si e mendojmë vetveten dhe pozicionin tonë në kozmos zbulimi i ekzistencës së formave të jetës në planetë të tjerë? Nuk ka asnjë dyshim, që qoftë edhe zbulimi i një mikrobi jashtëtokësor që mund të demonstrojë se ka evoluar i pavarur nga format e jetës mbi tokë, do të ndikonte në mënyrë domethënëse mbi vizionin që ne kemi mbi botën dhe do të sillte në shoqërinë tonë ndryshime të thellë po aq të rëndësishëm sa ata të revolucioneve të Kopernikut dhe të Darvinit: mund të quhej përfundimisht zbulimi më i madh shkencor i të gjithë kohërave. Dhe në rastin më ekstrem, nëse do të arrinim të interceptonim një mesazh të alienëve, ka shumë mundësi që ai të kishte një efekt shkatërrimtar mbi njerëzimin.

Një mesazh i MUNDSHËM...

Çfarë do të ndodhte nëse do të interceptonim një sinjal apo një mesazh me origjinë aliene? Çfarë do të thoshte saktësisht për njeriun zbulimi se nuk jemi të vetmet qenie inteligjente në univers? Shkencëtarët e Projektit Kolombi (në kuadër të programit të bashkëpunimit shkencor e teknologjik mes qeverisë italiane dhe asaj argjentinase) kanë ngritur një komision për të vendosur se si do të duhej të jepej lajmërimi në rast se do të interceptohej një sinjal alien dhe çfarë do të duhej bërë për të dhënë një përgjigje. Janë hipotizuar forma të ndryshme sinjalesh alienë. Rasti më elementar do të ishte ai i një lloj fari. Do të

bëhej fjalë thjesht për një akt komunikimi të ekzistencës së qytetërimi të tyre, për këdo që eksploron hapësirën.

Një rast më interesant do të ishte ai në të cilin fari do të transmetonte informacione mbi qytetërimin e tyre e ndoshta një ftesë oper t'u vënë në kontakt. Duke qenë se është e mundur të përfshih një sasi të madh informacioni në një sinjal radio apo lazer të shkurtër, mund të zbulojmë shumë gjëra vetëm duke analizuar sinjalin e shkurtër fillestar. Është e mendueshme që alienët të kenë zbuluar ekzistencën tonë në Tokë dhe që janë vënë në punë për të na kontaktuar. Mund të jenë vënë në dijeni mbi ne në mënyra të ndryshme. Sinjalet e radios që shkojnë nga një qoshe e tokës në tjetrën, është e mundur që të përhapen edhe në hapësirë me shpejtësinë e dritës. Një antenë me ndjeshmërinë e duhur mund të ketë përcjellë sinjalet tona radiofonike dhe televizive që tani duhet të kenë udhëtuar me dhjetëra vite dritë. Një impiant edhe më i ndjeshëm mund të përcjellë rrezet gama të prodhuar nga eksperimentet bërthamore të kryer në atmosferën tonë. Prania jonë mund të deduktohet edhe duke u bazuar në faktin që toka është një Planet në të cilin ishte e mundur të zhvillohej një formë inteligjente jete.

Është e mundur edhe që alienët të kenë vizituar herë pas here tokën, duke ditur që shpejt kjo formë jete inteligjente do të zhvillohej. Mund të kenë lënë apo dërguar shumë kohë më parë një sondë me qëllimin që t'i lajmëronte për zhvillimin e një shoqërie teknologjike. Një sondë e tillë mund të jetë në orbitë në sistemin diellor. Por ekziston edhe një tjetër mundësi: ajo e zbulimit të një mesazhi alien mbi tokë, apo pranë saj. Cilat do të ishin pasojat e mundshme të interceptimit të një mesazhi alien mbi tre hipotezat alternative që lidhen me origjinën e jetës? Nëse zbulojmë ekzistencën e qenieve jashtëtokësore, a do të ishte e mundur të vazhdonim të këmbëngulnim në tezën e mrekullisë së origjinës së jetës. Natyrisht, nga pikëpamja logjike, nuk është e

pamundur që jeta ka lindur mrekullisht dhe është përhapur në univers. Megjithatë, kjo hipotezë do të hidhte dyshime mbi teorinë e origjinës hyjnore të inteligjencës dhe vetëdijes. Një sinjal alien do të na detyronte të arrinim në konkluzionin që inteligjenca është e zhvilluar në mënyrë të pavarur nga ne në pjesë të tjera të universit dhe se homo sapiens-i nuk zë një vend të veçantë në rendin e gjërave.

Kodi i padëshifrueshëm

'Le chiffre indéchiffrable'

Pas zbërthimit të formës së thjeshtë të kodit të zëvendësimit, të gjithë u vunë në kërkim për një sistem të ri enkriptimi, një sistem i cili do të rikthente komunikimin e sigurtë. Në mesin e shekullit XIX, atëherë kur po zhvillohej telegrafi, enkriptimi i sigurtë po bëhej një domosdoshmëri. Në fund të fundit, telegrafi ishte ekuivalenti viktorian i internetit.

Sistemi që mund të garantonte privacinë ishte kodi Vigenere, i cili kish marrë emrin e njërit prej shpikësve të tij, kriptografi i shekullit XVII, Blaise de Vigenere. Shumë shpejt, ky kod u bë i njohur si 'le chiffre indéchiffrable' apo 'kodi i padëshifrueshëm'. Ai u përdor nga qeveri, diplomatë, gjeneralë dhe biznesmenë. Të gjithë besonin se ishte i pacënueshëm, përveç një njeriu, dijetarit viktorian Charles Babbage. Ai besonte se kodi kishte të meta dhe iu vu punës për të gjetur ato.

Për më shumë se një shekull, historia e betejës së Babbage kundër kodit Vigenere mbeti sekret, por një studiues danez, Ole Franksen, ka sjellë tashmë në dritë këtë episod të historisë së kriptografisë. Përse kërkimi i Babbage u mbajt i fshehur për shumë vite? Thyerja e kodeve, në natyrën e vet është një veprimtari e fshehtë, kështu që ndoshta nuk përbën habi fakti

që puna e deshifrujesve të kodeve mbahet sekret prej atyre që janë në pushtet.

Figura më intriguese në kriptanalizën e shekullit XIX është Charles Babbage, gjeniu ekscentrik britanik i njohur më së shumti për zhvillimin e projektit të kompjuterëve modernë. Babbage, i lindur në 1791, ishte një shkencëtar me interesa të shumtë, i cili ia dedikonte mendjen e tij çdo lloj problemi që i ngacmonte imagjinatën. Shpikjet e tij variojnë që nga shpejtësimatësi deri tek "kapësi i lopëve" - një pajisje që mund fiksohej tek lokomotivat me avull për të larguar bagëtitë nga shinat e hekurudhave. Babbage ishte gjithashtu i pari që kuptoi se gjerësia e një unaze peme varej nga moti në vitin korrespondues, duke deduktuar në këtë mënyrë se ishte e mundur të përcaktoje klimën në të kaluarën duke studiuar pemët e lashta.

Veç kësaj, Babbage u përpoq të merret me probleme që shkonin përtej fushës së shkencës dhe inxhinierisë. Kostoja e dërgimit të një letre brenda Britanisë dikur lidhej me distancën që letra duhej të përshkonte, por Babbage arriti në përfundimin se puna që kërkohej për të përlllogaritur çmimin e çdo letre kushtonte më shumë se sa postimi. Në vend të kësaj, ai propozoi një çmim të vetëm për të gjithë letrat.

Motorrët

Momenti i kthesës në karrierën shkencore të Babbage ndodhi në 1821, kur ai dhe astronomi John Herschel po ekzaminonin një seri tabelash matematike, që përdoreshin si bazë për përlllogaritjet astronomike, inxhinierike dhe ato për lundrim. Të dy shkencëtarët qenë të indinjuar nga numri i gabimeve në tabela, që do të shkaktonte të meta të mëdha në kalkulime të rëndësishëm. Një set tabelash, për gjetjen e gjerësisë dhe gjatësisë gjeografike në det, përmbante 1000 gabime. Në të vërtetë, shumë mbyjtje anijesh dhe fatkeqësi inxhinierike kishin ardhur për shkak të tabelave defektoze.

Këto tabela matematikore ishin përlllogaritur me dorë dhe gabimet qenë rezultat i gabimeve njerëzore. Një gjë e tillë, e shtyu Babbage të bërtasë: "Lus shumë Zotin që këto përlllogaritje të ishin bërë me avull!" Një gjë e tillë

shënoi fillimin e një përpjekjeje të jashtëzakonshme për të ndërtuar një makinë, që të ishte në gjendje të bënte llogari të tabelave pa gabime. Babbage projektoi Motorrët e Diferencës Nr. 1 dhe Nr. 2, makina të mrekullueshme llogaritjesh me mijëra pjesë precizioni. Ai shkoi më tej duke ndërtuar Motorrin Analitik, i cili ishte i programueshëm dhe si rrjedhim një pararendës i kompjuterit modern. Fatkeqësisht, për shkak të mungesës së financimeve, Babbage nuk përfundoi asnjë prej makinave të tij.

Arti i deshifrimit

Më pak i njohur është interesi i Babbage në kodet, që nisi kur ishte ende shumë i ri. Më vonë, ai kujtonte se si talenti e fuste herë pas here në telashe: "Djemtë më të mëdhenj bënin kode, por nëse shtija në duar disa fjalë, zakonisht arrija t'i zbërtheja. Pasojat e kësaj gjenie qenë herë pas here të dhimbshme: pronarët e kodeve të zbërthyer ndonjëherë më rrihnin, ndonëse fajin e kish idiotësia e tyre". Ai nuk u dekurajua. "në mendimin tim, deshifrimi është një prej arteve më të mrekullueshëm", ka shkruajtur në autobiografinë e tij.

Ndonëse njihej kryesisht si shpikës, Babbage fitoi reputacion të madh edhe si një kriptanalist, në gjendje të zbërthente çdo lloj kodi dhe të njerëz të shumtë vinin tek ai për gjithfarësoj problemesh. Për shembull, ai ndihmoi një biograf që ishte në hall dhe që po përpiqej të deshifronte shënimet me stenografi të John Flamsteed, i pari Astronom Mbretëror i kombit. Ai i erdhi gjithashtu në ndihmë një historiani, duke i deshifruar një kod të Henrietta Maria, mbretëreshë e Karlit I dhe më pas, në vitin 1854, ai bashkëpunoi me një avokat për të siguruar prova të rëndësishme në një çështje ligjore.

Por arritja më e madhe kriptografike e Babbage ishte deshifrimi i kodit Vigenere, një arritje që nuk e bëri kurrë publike dhe që kaloi pa u mësuar deri kur një historian i shkencës analizoi shënimet e Babbage në vitet 1970.

Zbërthimi

Kodi Vigenere është i bazuar në një versio të shumëfishuar të kodit të Çezarit. Kodi i Çezarit kodon një mesazh duke zhvendosur çdo gërmë për një numër të caktuar vendesh. Për shembull, çdo gërmë mund të zhvendoset një herë, kështu që a-ja kriptohej si b, b-ja si c, e kështu me radhë. Duke qenë se alfabeti anglez ka 26 gërma, mund të zgjedhësh një zhvendosje gërmash deri në 25 vende. (Një zhvendosje me 26, çon secilën gërmë në pozicionin origjinal, duke e lënë mesazhin të pakoduar).

Të gjithë zhvendosjet e mundshme përfaqësohen nga një prej reshtave me numra në një tabelë kodi. Për të koduar një mesazh duke zbatuar zhvendosjen me një gërmë sipas kodit të Çezarit, për shembull, do të duhet të shohësh çdo gërmë në reshtin më të lartë dhe ta zëvendësojmë me gërmën korresponduese në reshtin 1. Kështu mesazhi "mbro anën lindore", shndërrohet në "NCRRP BNJDNJ LLJNJEPRE".

Kodi i Çezarit është i lehtë të zbërthehet, duke analizuar shpeshtësinë me të cilën gërmat shfaqen në kod dhe duke krahasuar rezultatin me shpeshtësinë mesatare për gërmat në alfabet. Për shembull, gërma "e" është përgjithësisht gërma më e përdorur në anglisht, kështu që cilado gërmë ta zëvendësojë do të jetë gërma më e përdorur në tekstin e koduar. Por, kodi Vigenere nuk mund të zbërthehet me anë të analizimit të shpeshtësisë.

Kjo ndodh sepse kodi Vigenere përfshin jo një, por disa zhvendosje të Çezarit. Për shembull, mesazhi kodohet duke përdorur gërma të ndryshme nga reshtat 1 dhe 2. Kështu, një gërmë shndërrohet në dy gërma të tjera. Një gjë e tillë e dëmton aftësinë e analizës së shpeshtësisë si një teknikë deshifrimi. Më keq akoma, një gërmë në tekstin e koduar përfaqëson dy gërma në mesazhin origjinal.

Tabela e deshifrimit njihet zakonisht si kuadrati Vigenere. Një mesazh mund të kodohet duke përdorur çdo numër reshtash në çdo lloj rendi. Rendi i reshtave mund të përcaktohet nga një fjalë kyçe: fjala "JOHN" do të nënkuptonte ciklimin në për reshta J, O, H, N, J, O, H, N (domethënë reshtat 9, 14, 7, 13, 9, 14, 7, 13) e kështu me radhë. Ashtu si me të gjithë kodet,

personi që merr mesazhin duhet të njohë mënyrën e kodimit, gjë që gjithashtu përcaktohet nga fjala kyç.

Kodi i Çezarit njihet si kod zëvendësimi monoalfabetik, për arsye se secila gërmë në mesazh kodohet në vetëm një mënyrë. Kodi Vineger njihet si një kod polialfabetik deshifrimi, për arsye se secila gërmë në mesazh mund të kodohet në mënyra të ndryshme, në varësi të kodit Vinegere që është përdorur.

ë c~

uS+R

e mundur në atë kohë që të martoheshe me kunatin tënd. Pengesë lehtësisht e xhirueshme për një grua me pushtet të tillë, për më tepër nënë e një Pape. Në fakt, nga njëra anë Ugo gënjeu nën betim duke pohuar se Guido nuk ishte vëllai për babë i tij, ndërsa nga ana tjetër Marocia verboi vëllain e tretë të tyre, Lamberton, Dukë të Toskanës, i cili kishte akuzuar Ugon për tradhti, ndërsa i paarmatosuri Gjoni i XI-të nga ana e tij, bekoi martesën midis së ëmës dhe babait të ri të tij në dhomat e Kastel Sant'Anxhelos.

Marocia dukej e papërmbajtshme, çdo projekt i saj, çdo dëshirë e saj, çdo plan i saj, boll që ta mendonte dhe menjëherë ai konkretizohej. Nuk e dinte se pak kohë më pas do të ishte pikërisht gjaku i gjakut të saj ai që do ta ndalonte. Ishte pikërisht Alberiku i II-të "ai bir që nuk e kishte dashur kurrë ishte pjesa e errët, i pakapshëm në vetvete që herët a vonë, siç e kishte ditur gjithmonë, do ta mundte". (Laura Toskano "Jeta e jashtëzakonshme dhe e ndyrë e Marocias që deshi të bënte Perandoren"). Sapo kishte mbushur të 23-at, ai ishte portreti i nënës së vet. "Shumë i hijshëm dhe i fuqishëm si person", siç do të shkruhej shekuj më pas, "nga Marocia kishte marrë bukurinë, mendjen e lartë dhe ambicien; nga i ati kurajën, guximin dhe nxehtësinë".

Gjithçka ndodhi papritmas prej një fataliteti gjatë ceremonisë martesore. Arroganti Ugo i Provansës në fakt pretendoi që t'i njiheshin nderimet mbretërore që i takonin dhe të ishte jo një pap i çfarëdoshëm, por Alberiku i II-të personalisht ai që t'i servirte verën, në shenjë nënshtrimi dhe respekti. Djaloshi, krenar, refuzoi dhe madje derdhi nga njerku

gotën e verës që kishte në dorë, duke marrë si përgjigje një shpullë. Në këtë pikë "edhe muzikantët u ndalën. Marocia e ngurosur priste reagimet e të birit. Ai e shikoi dhe buzëqeshi. Atëhere ajo kuptoi se momenti i frikshëm dhe i pritur qysh nga lindja e tij kishte ardhur". Alberiku i II-të shtathedhur dhe krenar doli nga salla, "i ndjekur menjëherë nga të rinjtë Franxhipane, Kapicuki, Kreshenci e Pierleoni. E gjithë fisnikëria romane ishte rreshtuar".

Në një çast krijoi një revoltë midis atyre, të lodhur nga stërfuqia e Marocias, donin të hakmerreshin. Menjëherë kështjella u sulmua nga çdo anë "patkonjtë e kuajve kumbonin me zhurmë në sallat e mëdha, në korridoret e gjerë, përgjatë rampës helikoidale. Tërbimi i atij sulmi të papritur nuk u ndal përpara asgjëje". Ugo tentoi arratisjen duke zbritur me një litar, por u kap dhe masakrua me të gjithë ndjekësit e tij. Edhe Papa Gjoni i XI-të u tërhoq mënjanë dhe u izolua. Aty për aty, në konfuzionin e krijuar "askush nuk e vrau mendjen për Marocian që edhe njëherë akoma u braktis. Por kësaj radhe as ajo nuk tentoi të shpëtonte, siç do të kishte bërë sigurisht nëqoftëse armiku do të kishte qenë i ndryshëm". Kur gjithçka mbaroi dhe njerëzit e Alberikut të II-të u rikthyen në dhomën ku kishte qenë banketi, atë e gjetën aty, "të vetme, duke ndenjur me krenari, e gatshme që të ndiqte fatin e saj". Fillimisht u mbyll në një kuvend, u vra brutalisht pak më vonë nga disa doras të dërguar nga i biri.